

RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit Msc në Financë-bankë

Ofruar nga Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Dorian MATRAKU

Prof. Asoc. Dr. Etleva BAJRAMI

Handwritten signatures in blue ink, one above the other, corresponding to the names listed.

(Korrik / 2018)

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Msc në Financë-bankë

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë"
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Ekonomike
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Urdhër Nr. 482, datë 03.10.2011
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	Urdhër Nr. 291, datë 11.07.2012
5	Titulli i programit të studimit:	Msc në: Financë-bankë
6	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
8	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	7
16	Numri i studentëve për këtë program studimi	270

Shënim:

Verifikimi ligjor sipas pikave si më sipër kryhet paraprakisht nga specialist/ët e APAAL që ndjekin këtë vlerësim

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Msc në Financë-bankë

Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” është licensuar me VKM nr. 177, datë 19.02.2009, vendim i cili lejon hapjen e institucionit “Shkolla e Lartë Private mesdhetare e Shqipërisë”. Shkolla e Lartë Private mesdhetare e Shqipërië” ka filluar aktivitetin e vet në vitin 2010.

Në bazë të urdhrit nr.124, datë 29.03.2012, “Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë” është akredituar institucionalisht.

Departamenti Financë, Bankë dhe Kontabilitet ofron Masterin shkencor Msc në Financë - bankë. Ky program është licensuar me Urdhër Nr. 482, datë 03.10.2011 të MASH bazuar në vendimin e Këshillit të Akreditimit Nr. 6, datë 16.09.2011.

Msc në Financë-bankë është akredituar për herë të parë me Urdhër nr. 291, datë 11.07.2012 të MASH. Ky Master është licensuar të realizohet me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij do të jetë 2 dy vite akademike

Programi i studimit Msc në Financë-bankë i nënshtrohet procesit të riakreditimit. Grupi i punës zhvilloi vizitë dy ditore pranë UMSH. Gjatë vizitës u kryen takime me Dekanin, Përgjegjës in e Departamentit të Financë, Bankë dhe Kontabilitet, që është edhe përgjegjës i Msc në Financë-bankë, pedagogët që japin mësim në programin e studimit, kordinatoren e masterit, grupin e punës së Raportit të Vlerësimit të Brendshëm dhe drejtues të tjerë të njëjësive bazë. Gjithashtu u vëzhguan ambjentet në të cilat zhvillohet mësimi i programit të studimit Msc në Financë-bankë. Institucioni ofron programet e studimit në një godinë relativisht të re dhe me infrastrukturë bashkëkohore. Auditorët janë të pajisur me të gjitha kushtet dhe mjetet e nevojshme për zhvillimin cilësor të procesit të mësimt.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

1. Prof. Asoc. Dr. Doriana Matraku
2. Prof. Asoc. Dr. Etleva Bajrami

Menaxhere vlerësimi e kësaj procedure është specialistja e ASCAL Znj. Majlinda Demirneli.

Më datë 19.06.2018 përmes sistemit Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. UMSH përcjell në ASCAL nëpërmjet shkresës nr. 301/6 prot, datë 26.06.2018 Objeksione për Draft – Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit Msc në Financë - bankë. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pasi lexoi me kujdes komentet ndaj draft raportit

vendosi të mos bëj ndryshim në këtë draft raport. Ky draft mer formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit, Vendim nr. 334, dt. 08.06.2012

- a) Të shtohet numri i pedagogëve me kohë të plotë dhe realizohet plotësimi i mëtjshëm i strukturave përkatëse universitare si departament;
- b) Të plotësohet shpërndarja e ngarkesës në auditor dhe emri i pedagogut në lëndën Metodat e kërkimit shkencor;
- c) Të ndryshohet literatura bazë në lëndën "Strategjitë e Marketingut bankar" dhe literatura e huaj e përmendur në program përfshin: Marketing Management dhe Foundation of Marketing;
- d) Të saktësohet emërtimi i lëndës "Menaxhimi Strategjik i Institucioneve Financiare" meqënëse programi flet më shumë për "Menaxhimin strategjik" në përgjithësi se sa për manaxhimin strategjik të Institucioneve financiare, duke saktësuar edhe titullarin e lëndës (E. Leskaj apo D. Salko);
- e) Të përmirësohet ose të ndryshohet programi i lëndës "Financat e korporatave" pasi duket se përsërit në një shkallë shumë të madhe "Drejtimin Financiar Ndërkombëtar";
- f) Të saktësohet emri i pedagogut përgjegjes dhe literatura bazë për lëndën "Kontabiliteti Financiar - Standartet Ndërkombëtare";
- g) Të mbahet parasysh që lënda "Metodat bashkëkohore të Analizës Financiare" të mos jetë e përfshirë në nivelin bachelor. Gjithashtu të mënjanohet mospërputhja e rrjetit të orëve sipas planit mësimor (3/3) me rrjetin e orëve të parashikuar në syllabusin përkatës (2/2);
- h) Të rregullohet plani mësimor, pasi lëndët "Menaxhimi Bankar" dhe "Kreditimi dhe Analiza e Kredisë" kanë program të ngjashëm;
- i) Të sigurohet që studentët e këtij programi studimi duhet të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a) Për Rekomandimin "Të shtohet numri i pedagogëve me kohë të plotë dhe realizohet plotësimi i mëtjshëm i strukturave përkatëse universitare si departament", institucioni ka punësuar pedagogë me grada e tituj shkencorë për plotësimin e nevojave në lëndët e Msc Financë-bankë. **Ky rekomandim është plotësuar.**
- b) Për rekomandimin "Të plotësohet shpërndarja e ngarkesës në auditor dhe emri i pedagogut në lëndën Metodat e kërkimit shkencor", në syllabusin e lëndës "Metodat e

kërkimit shkencor”, gjendet shpërnardja e ngarkesës në auditor dhe emri i pedagogut.

Ky rekomandim është plotësuar.

- c) Për rekomandimin “Të ndryshohet literatura bazë në lëndën Strategjitë e Marketingut bankar dhe literatura e huaj e përmendur në program përfshin: Marketing Management dhe Foundation of Marketing”, institucioni ka marrë masat për plotësimin e rekomandimit duke ndryshuar në këtë lëndë si literatura bazë ashtu edhe literatura ndihmëse. **Ky rekomandim është plotësuar.**
- d) Për rekomandimin “Të saktësohet emërtimi i lëndës "Menaxhimi Strategjik i Institucioneve Financiare" meqënëse programi flet më shumë për "Menaxhimin strategjik" në përgjithësi se sa për manaxhimin strategjik të Institucioneve financiare, duke saktësuar edhe titullarin e lëndës (E. Leskaj apo D. Salko)”, institucioni ka saktësuar titullarin e lëndës, i cili është i njëjti në të dy lëndët. Përsa i përket programit, ai vazhdon të jetë i njëjtë, mdaje edhe literatura bazë është e njëjtë, me përjashtim të një literature, e cila është bazë tek "Menaxhimi Strategjik i Institucioneve Financiare" ndërkohë që është literaturë ndihmëse tek lënda "Menaxhimi Strategjik". Emërtimi i lëndës nuk ka ndryshuar. **Ky rekomandim është plotësuar pjesërisht.**
- e) Për rekomandimin “Të përmirësohet ose të ndryshohet programi i lëndës "Financat e korporatave" pasi duket se përsërit në një shkallë shumë të madhe "Drejtimin Financiar Ndërkombëtar", institucioni ka ndryshuar programin e lëndës "Financat e korporatave". **Ky rekomandim është plotësuar.**
- f) Për rekomandimin “Të saktësohet emri i pedagogut përgjegjes dhe literatura bazë për lëndën Kontabiliteti Financiar - Standartet Ndërkombëtare", Institucioni ka marrë masat për plotësimin e syllabusit me emrin e pedagogut. **Ky rekomandim është plotësuar.**
- g) Për rekomandimin “Të mbahet parasysh që lënda "Metodat bashkëkohore të Analizës Financiare" të mos jetë e përfshirë në nivelin bachelor. Gjithashtu të mënjanohet mospërputhja e rrjetit të orëve sipas planit mësimor (3/3) me rrjetin e orëve të parashikuar në syllabusin përkatës (2/2) “ nga verifikimi rezulton që kjo lëndë nuk është në ciklin e parë të studimeve, Bachelor dhe është menjanuar mospërputhja e rrjetit të orëve sipas planit mësimor (3/3) me rrjetin e orëve të parashikuar në syllabusin përkatës (2/2). **Ky rekomandim është plotësuar.**
- h) Për rekomandimin “Të rregullohet plani mësimor, pasi lëndët "Menaxhimi Bankar" dhe "Kreditimi dhe Analiza e Kredisë" kanë program të ngjashëm”, nga syllabuset e lëndëve vihet re që nuk janë të ngjashme as në tema as në Literaturë. **Ky rekomandim është plotësuar.**

- i) Për rekomandimin “Të sigurohet që studentët e këtij programi studimi duhet të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare”, sipas RVB Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” programet e studimit realizohen në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të dala në funksion të tij. Referuar Udhëzimit nr. 14, datë 28.03.2011, ndryshuar në vazhdim me Udhëzimin Nr. 52, datë 3.12.2015 dhe udhëzimin nr.11, datë 30.6.2016 studentët e diplomuar pranë UMSH kanë shlyer gjithë detyrimet që rrjedhin nga udhëzimet e mësipërme për mbrojtjen dhe certifikimin e gjuhës së huaj. Edhe gjatë vizitës na u komunikua një fakt i tillë. **Ky rekomandim është plotësuar.**

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” është institucion jopublik i arsimit të lartë me karakter akademik dhe shkencor. Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” është licensuar me VKM nr. 177, datë 19.02.2009, vendim i cili lejon hapjen e institucionit “Shkolla e Lartë Private mesdhetare e Shqipërië”. Shkolla e Lartë Private mesdhetare e Shqipërië” ka filluar aktivitetin e vet në vitin 2010. Në bazë të urdhrit nr.124, datë 29.03.2012 “Shkolla e Lartë Private mesdhetare e Shqipërië” është akredituar institucionalisht.

Departamenti Financë Bankë dhe Kontabilitet ofron Masterin shkencor Msc në Financë-bankë. Msc në Financë-bankë. është licensuar me Urdhër Nr. 482, datë 03.10.2011 të MASH bazuar në vendimin e Këshillit të Akreditimit Nr.6, datë 16.09.2011.

Msc në Financë-bankë. është akredituar për herë të parë me Urdhër nr. 291, datë 11.07.2012 të MASH. Ky Master është licensuar të realizohet me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij do të jetë 2 dy vite akademike. Vizioni i Universitetit “Mesdhetar të Shqipërisë”, i specifikuar në Statutin e Universitetit, është krijimi i një institucioni të arsimit të lartë cilësor i cili ofron vlera të vërteta qytetarie dhe profesionalizmi. Misioni i Universitetit “Mesdhetar të Shqipërisë” përfshin ofrimin e arsimit të lartë dhe veprimtarisë krijuese në fushat e shkencave ekonomike, juridike, marrëdhënieve ndërkombëtare, psikologjike, sociale dhe politike. Misioni përfshin zhvillimin dhe mbrojtjen e dijeve nëpërmjet mësimdhënies dhe veprimtarisë akademike që kryhet brenda dhe jashtë vendit.

Misioni i programit të studimit Master Shkencor në Financë-bankë. është përgatitja e specialistëve për sektorin publik, privat dhe jofitimprurës në fushën e financës. Qëllimi i Universitetit “Mesdhetar të Shqipërisë” është: të ofrojë studime universitare në cikle të ndryshme, të bazuara në njohuri dhe

kërkime shkencore, për të përgatitur specialistë dhe shkencëtarë të rinj; të ofrojë gjithashtu programe studimi afatshkurtra për kualifikime dhe specializime si dhe për përditësimin e dijeve të fituara.

Strategjia afatshkurtër e programit të studimit Msc në Financë-bankë. të Universitetit “Mesdhetar të Shqipërisë” është zhvillimi i punës shkencore në përsosjen e vazhdueshme të kurrikulave mësimore për rritjen e mëtejshme të nivelit shkencor. Gjithashtu në strategjinë afatshkurtër është edhe rritja e pjesëmarrjes së pedagogëve në programe dhe projekte kombëtare dhe ndërkombëtare që do të rrisin nivelin e tyre profesional, si dhe forcimi i mëtejshëm i lidhjeve shkencore të Universitetit “Mesdhetar të Shqipërisë” nëpërmjet bashkëpunimit institucional, shkëmbimit të eksperiencave, etj. Strategjia në afat të mesëm do të synojë në ndërtimin e programeve të reja të studimit të ciklit të dytë dhe të ciklit të tretë. Gjithashtu strategjia në afat të mesëm do të synojë ristrukturimin dhe zhvillimin e mëtejshëm i zyrës së projekteve për aplikime të mëtejshme në organizma ndërkombëtar, si dhe pjesëmarrje më e gjerë e stafit në konkurse kombëtare dhe ndërkombëtare.

Objektivat e programit të studimit Msc në Financë-bankë. përputhen me strategjitë. Sipas RVB programi i studimit Msc në Financë-bankë. në veprimtarinë e tij paraqitet në përputhje me planin strategjik të zhvillimit institucional, kërkimit shkencor, bashkëpunimit dhe ndërkombëtarizmit 2012-2017. Programi i studimit Msc Financë-bankë. ka si objektiv të zhvillojë dijet e mëtejshme të studentët që kanë formim të nivelit Bachelor. Programi i studimit Msc në Financë-bankë. ka objektiv të pajisë studentët me njohuri teorike dhe praktike si dhe një vizion për studime të thelluara në fushën e financës. Në këtë program universiteti ka si objektiv ofrimin e kushteve optimale të zhvillimit të mësimin dhe angazhimin e një stafi të kualifikuar.

Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” përbëhet nga 3 fakultete:

1. Fakulteti i Shkencave Ekonomike
2. Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare
3. Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale, dhe Politike

Secili fakultet ofron studime të nivelit të parë dhe të dytë. Fakulteti i Shkencave Ekonomike ofron studime në ciklin e parë :

1. “Bachelor ne Shkenca Ekonomike” me profile:

— Financë, Bankë dhe Kontabilitet

— Adinistrim Biznesi

— Biznes dhe Ligj

2. “Bachelor në Informatikë Biznesi”

Fakulteti i Shkencave Ekonomike ofron studime në ciklin e dytë:

1. “Master i Shkencave” në Financë - bankë
2. “Master i Shkencave në Sisteme Informacioni në Biznes
3. “Master Profesional” në Administrim Biznesi

4. “Master Profesional” në Menaxhim Biznesi me profile:

- Menaxhim Arsimi
- Menaxhim i pasurive të Paluajtshme
- Menaxhim Turizmi
- Menaxhim Arti
- Menaxhim Shëndeti

5. “Master Profesional” në Sisteme Informacioni në Biznes

Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjal administrativ i cili siguron përmbushjen e misionit, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të institucionit. Anëtarët emërohen dhe shkarkohen nga Bordi i Qendrës Mesdheu dhe janë të punësuar me kohë të pjesshme me mandat pesëvjeçar.

Në Universitetin “Mesdhetar të Shqipërisë”, organet drejtuese janë si më poshtë:

1. Senati Akademik
2. Rektorati
3. Dekanatet
4. Asambletë e personelit akademik të njësive kryesore
5. Bordi i Administrimit

Në Universitetin “Mesdhetar të Shqipërisë”, autoritet drejtuese janë si më poshtë:

- Rektori
- Dekanët
- Drejtuesit e njësive bazë
- Drejtuesit e qendrave/instituteve të kërkimit
- Administratori i universitetit
- Administratorët e njësive kryesore

Nga vizita në Institucion na u komunikua se Fakulteti i Shkencave Ekonomike nuk ka Zv.dekan, ndërkohë që janë 3 Zv.Rektor me detyra të ndara, për ecurinë e mësimdhënies, për kërkimin shkencor dhe për burimet njerëzore.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve ¹
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	

¹ GVJ duhet të shprehen me shkrim për çdo standard në mënyrë të përmbledhur (mbështetur në kriteret majtas). Në fund të çdo rubrike, grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardeve në tërësi.

<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>Programi i studimit Msc Financë-bankë është në funksion të misionit dhe qëllimit të Universitetit “Mesdhetar i Shqipërisë” për të ofruar arsim të lartë dhe veprimtari krijuese në fushat e shkencave ekonomike, juridike, marrëdhënieve ndërkombëtare, psikologjike, sociale. Programi i studimit Msc në Financë -bankë synon thellim të njohurive ekonomike.</p> <p>Programi i studimit hartohet në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit. Strategjia e institucionit është bazuar në prirjet kryesore të zhvillimit të arsimit të lartë në Shqipëri dhe vende të tjera, ndërkohë që prirjet e zhvillimit të arsimit të lartë janë komfort prirjeve të zhvillimeve ekonomike të vendeve.</p> <p><i>Institucioni nuk ka kryer një studim të mirëfilltë të tregut të punës.</i></p> <p>Institucioni ka lidhur një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me biznese vendase të cilat ndihmojnë institucionin që të jetë sa më pranë realitetit ekonomik. Institucioni në dokumentin “Strategjia 2017-2021” të programit të studimit Msc në Financë-bankë. ka dhënë edhe mënyrën sesi do të përshtaten dijet teorike dhe praktike të studentëve me nevojat e ekonomisë shqiptare dhe tregun e punës. Institucioni nëpërmjet bashkëpunimeve me bizneset vendase kupton dhe mban në konsideratë për programet e studimit nevojat e punës që bizneset cilësojnë. Mbajtja e kontakteve me studentët e diplomuar është një mënyrë e mirë për të kuptuar nevojën e tregut për punësim, dhe numrin e të diplomuarve në përputhje me diplomën, ky i fundit është një tregues i rëndësishëm në këtë drejtim.</p> <p>Programi i studimit pasqyron vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit. Zhvillimi i arsimit në të gjitha ciklet ka qenë dhe mbetet një vlerë e rëndësishme kulturore e kombit dhe ky program studimi kontribuon në lidhje me këtë.</p>
<p>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	

Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;

Strategjia e programit të studimit Msc në Financë-bankë. të Universitetit “Mesdhetar të Shqipërisë” është zhvillimi i punës shkencore në përsosjen e vazhdueshme të kurrikulave mësimore për rritjen e mëtejshme të nivelit shkencor si dhe ofrimi i programeve të studimit të ciklit të dytë. Programi i studimit është përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit.

Programi i studimit Msc në Financë-bankë është program i ciklit të dytë, i cili synon rritje të nivelit shkencor, duke thelluar njohuritë në fushën e financës. Plotëson synimin për të përgatitur specialist të zotë për tregun e punës si në sektorin publik edhe atë privat.

Sipas RVB, UMSH ka një plan të zhvillimit strategjik të IAL dhe ka parashikuar politikën e zhvillimit të programeve të studimeve master.

Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Kriteri 1 Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;

Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.

Studenti që ndjek këtë program e zhvillon atë në kohëzgjatjen prej 2 (dy) vitesh akademike, me kohë të plotë dhe fiton 120 kredite (ECTS).

Kjo është në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë nr. 80/2015, me synim krijimin e mundësive për mobilitet dhe transferim të tyre nga njëri institucion i arsimit të lartë në tjetrin, brenda dhe jashtë vendit. Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” funksionon në bazë të ligjit të sipërcituar dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore të këtij ligji.

Programi Msc në Financë-bankë, është i organizuar në 120 kredite (ECTS), në gjuhën shqipe, me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra), në përfundim të të cilëve të lëshohet Diplomë Master i Shkencave në “Financë-bankë.” dhe Suplementi i diplomës, jepet në gjuhën shqip dhe anglisht.

Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit. Programi i studimit Master i Shkencave në Financë-bankë. është në përputhje me nivelin e kualifikimit dhe i përket nivelit 7 sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimit.

Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.

Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.

Sipas RVB institucioni ka hartuar një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve master.

Fakulteti i Shkencave Ekonomike ka hartuar për programin e studimit Msc Financë-bankë. planin strategjik "Strategjia e zhvillimit 2017-2021" ku janë shprehur strategjitë afatshkurtër dhe afatmesëm si dhe synimet deri në vitin 2021. Në këtë plan strategjik institucioni përcakton misionin, objektivat, strategjitë dhe mënyrat që ai do të përdorë për të realizuar ato.

Sipas RVB institucioni ka hartuar një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit. Ndërkohë që nga dokumentacioni i dorëzuar cdo program studimi ka strategji specifike zhvillimi dhe specifikim për mënyrën se si institucioni synon të përmirësojë rezultatet e mësimdhënies dhe të të nxënit .

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Programi i studimit Msc Financë-bankë. i ofruar nga Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë" është në përputhje me misionin e Universitetit "Mesdhetar i Shqipërisë", me zhvillimin ekonomik të vendit dhe me nevojat e tregut të punës.
2. Programi i studimit Msc Financë-bankë. është program i ciklit të dytë të studimeve dhe është në përputhje me strategjinë e zhvillimit strategjik të UMSH. Ky program studimi synon rritje të nivelit shkencor, duke thelluar njohuritë në fushën e financës dhe përgatitur specialist të zotë.
3. Msc Financë-bankë, e zhvillon atë në kohëzgjatjen prej 2 (dy) vitesh akademike, me kohë të plotë dhe fiton 120 kredite (ECTS). Kjo është në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015. Programi i studimit Master i Shkencave në Financë Bankë është në përputhje me nivelin e kualifikimit dhe i përket nivelit 7 sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimit.
4. Institucioni ka hartuar një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programit të studimit Msc në Financë-bankë. Fakulteti i Shkencave Ekonomike ka hartuar për programin e studimit Msc Financë-bankë. planin strategjik "Strategjia e zhvillimit 2017-2021" ku janë shprehur strategjitë afatshkurtër dhe afatmesëm si dhe synimet deri në vitin 2021.

Standardet plotësohen plotësisht.

2. Struktura akademike e Fakultetit (departamentit përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Senati Akademik është autoriteti kryesor drejtues i cili siguron zbatimin e parimeve kushtetuese dhe ligjore mbi arsimin e lartë në Republikës e Shqipërisë, të autonomisë dhe lirisë akademike si dhe mbrojtjen e drejtat e studentëve. Senati miraton rregulloret e institucionit, propozon strukturën e përgjithshme të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, numrin e personelit të institucionit në të gjitha nivelet pranë Bordit të Administrimit, etj. Anëtarët e Senatit zgjidhen nga asambljetë e personelit akademik të njësive kryesore. Senati akademik përbëhet nga Drejtuesi Prof.Asoc. Dr. Nexhmi Dumani dhe 7 anëtarët. Rektori është autoriteti më i lartë akademik i institucionit, si dhe përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet akademike dhe protokollare. Rektori i universitetit drejton dhe përfaqëson institucionin në raport me të tretët për çështjet akademike. Rektori pranë Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë është Prof.Asoc. Dr. Nexhmi Dumani. Nga vizita në Institucion na u komunikua se Fakulteti i Shkencave Ekonomike nuk ka Zv.dekan, ndërkohë që janë 3 Zv.rektor me detyra të ndara, për ecurinë e mësimdhënies, për kërkimin shkencor dhe për burimet njerëzore.

Njësitë kryesore të Universitetit “Mesdhetar i Shqipërisë” janë 3 fakultetet:

1. Fakulteti i Shkencave Ekonomike
2. Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare
3. Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale, dhe Politike

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Struktura akademike e Fakultetit/Departamentit
- Fakulteti, Organizimi hierarkik i Fakultetit

Dekani është autoriteti drejtues në secilin prej fakulteteve të Universitetit. Strukturat përbërëse të Universitetit janë njësitë kryesore, njësitë bazë dhe njësi të tjera të ngritura pranë universitetit dhe të përcaktuara në statut. Dekani i Fakultetit të Shkencave Ekonomike, ku edhe ofrohet programi i studimit Msc. Financë - bankë. është Prof.Asoc. Dr. Alqi Naqellari.

Përgjegjësi i Njesisë bazë (departamentet) është autoriteti drejtues i njesisë bazë. Njësitë bazë të Universitetit “Mesdhetar i Shqipërisë” pranë Fakultetit të Shkencave Ekonomike janë:

- Departamenti i Financë, Bankë dhe Kontabilitet
- Departamenti i Ekonomisë
- Departamenti i Informatikës dhe i Formimit Shkencor

Departamenti i Financë, Bankë dhe Kontabilitet është përgjegjës për ofrimin e programit të studimit Msc Financë-bankë.

Përgjegjëse e Departamentit Financë, Bankë dhe Kontabilitet është Dr. Rudina Qurku.

Përgjegjëse e Departamentit të Ekonomisë është Dr. Ira Gjika.

Përgjegjëse e Departamentit të Informatikës dhe i Formimit Shkencor është Dr. Dolantina Hyka.

☑ Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Sic është përmendur më sipër Departamenti i Financë, Bankë dhe Kontabilitet është përgjegjës për ofrimin e programit të studimit Msc Financë -bankë.

Departamenti i Financë, Bankë dhe Kontabilitet në vitin aktual ka në përbërjen e tij 12 pedagogë efektiv(PAE) dhe 9 pedagogë me kontratë (PAK) apo të ftuar.

Departamentit i Ekonomisë ka 13 pedagogë efektivë (PAE) dhe 5 pedagogë me kontratë (PAK) apo të ftuar.

Departamenti i Informatikës dhe i Formimit Shkencor ka në përbërjen e tij 14 pedagogë efektiv (PAE) dhe 6 pedagogë me kontratë (PAK) apo të ftuar.

Përsa i përket stafit ai është relativisht stabël, kjo e deklaruar edhe në vizitën në institucion. 2 pedagogë që janë larguar janë larguar për arsye karriere. Gjithashtu gjatë vizitës na u deklarua se institucioni ka punësuar vazhdimisht pedagogë të rinj për plotësimin e nevojave akademike. Institucioni ka punësuar kryesisht staf të ri në moshë ende pa tituj dhe grada shkencore. Vëmë re se Përgjegjësit e njësisë bazë mbajnë gradën shkencore Doktor.

☑ Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Listë staf administrativ, Senati Akademik & Bordi i Administrimit dhe funksione të tjera

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;	Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë“ organizohet në bazë të Statutit dhe Rregulloren e UMSH, ku janë të përcaktuara në mënyrë të strukturuar organet drejtuese, autoritet drejtuese dhe gjithë strukturat përkatëse për përmbushjen e misionit të tij.
Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;	
Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;	Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” ka në përbërje të tij 3 (tre) fakultete. 1. Fakulteti i Shkencave Ekonomike 2. Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare 3. Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale, dhe Politike
Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;	
Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.	Fakulteti organizohet në njësi bazë. Fakulteti i Shkencave Ekonomike përbëhet nga 3 njësi bazë (departamente): 1. Departamenti i Financë, Bankë dhe Kontabilitet

	<p>2. Departamenti i Ekonomisë 3. Departamenti i Informatikës dhe i Formimit Shkencor</p> <p>Objektivat dhe misionet e tyre janë të mirëpërcaktuar në rregulloren e secilit departament.</p> <p>Departamenti i Financë, Bankë dhe Kontabilitet, përgjegjës për programin e studimit ka në përbërje të tij mbi 7 (shtatë) anëtarë efektiv dhe pedagogë efektiv me gradën shkencore “Doktor” mbi 3 (tre) pedagogë. Në këtë departament janë 6 pedagogë efektiv me gradën shkencore të paktën “Doktor”.</p>
<p>Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.</p>	
	<p>Drejtuesi i njësisë kryesore Fakultetit të Shkencave Ekonomike ka fituar titull akademik dhe gradë shkencore, ndërkohë drejtuesit e njësisë bazë janë akademikë me gradën shkencore “Doktor” dhe kanë përgjegjshmëri për realizimin e programeve të studimit.</p>
<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Njësitë bazë dhe kryesore kryejnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Rregulloren për Organizimin dhe Punën e Fakultetit të Shkencave Ekonomike, si dhe në rregulloret e secilit departament.</p> <p>Njësitë bazë dhe kryesore kryejnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Rregulloren për Organizimin dhe Punën e Fakultetit të Shkencave Ekonomike ku është e përcaktuar që përgjegjësia për përcaktimin e nevojave për personel të ri akademik është e drejtuesve të njësisë bazë.</p> <p>Ndërsa në Statut përcaktohet se janë drejtuesit e njësisë kryesore të cilët i komunikojnë Rektorit nevojën për personel të ri dhe merret gjithashtu me organizimin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p>	
<p>1. Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” organizohet në bazë të Statutit dhe Rregullores së UMSH. Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” ka në përbërje të tij 3 (tre) Fakultete dhe secili Fakultet organizohet në njësi bazë. Fakulteti i Shkencave Ekonomike përbëhet nga 3 njësi bazë (departamente). Departamenti i Financë, Bankë dhe Kontabilitet, përgjegjës për programin e studimit ka në përbërje të tij mbi 7 (shtatë) anëtarë efektiv dhe pedagogë efektiv me gradën shkencore “Doktor” mbi 3 (tre) pedagogë.</p> <p>2. Njësitë bazë dhe kryesore kryejnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Rregulloren për Organizimin dhe Punën e Fakultetit të Shkencave Ekonomike, si dhe në rregulloret e secilit departament. Drejtuesit e njësisë kryesore dhe njësisë bazë të Fakultetit të Shkencave Ekonomike kanë titull/ gradë shkencore.</p>	

3. Drejtuesit e njësive kryesore dhe bazë pasi përcaktojnë dhe vlerësojnë nevojat për staf akademik të ri, realizojnë rekrutimin e personelit akademik.

Standardet plotësohen plotësisht.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Personeli akademik që jep mësim në programin e studimit Msc në Financë-bankë është i përbërë nga pedagogë efektiv dhe me kontratë. Përzgjedhja e personelit akademik në procesin e mësimdhënies është e rëndësishme. Personeli akademik harton, diskuton dhe në fund konkludon për ndërtimin e syllabuseve të lëndëve, që përbëjnë esencën e mësimdhënies. Personeli akademik efektiv në përgjithësi ka qenë në rritje dhe me qëndrueshmëri, ndërkohë që personeli akademik me kontratë ka qenë stabil. Në një masë pothuaj mbi 50 % të personelit me kontratë është pothuaj i njëjti që nga fillimi i programit.

Për vitin akademik **2016-2017** personeli akademik i angazhuar për programin e studimit është **13** pedagogë në total, ku **7** janë PAE dhe **6** janë PAK, raporti PAE/PAK është **54%/46%**.

Për vitin akademik **2017-2018** personeli akademik i angazhuar për programin e studimit është **15** pedagogë në total, ku **8** janë PAE dhe **7** janë PAK, raporti PAE/PAK është **53%/47%**.

(Të dhëna të zgjeruara gjenden në Aneks)

Ngarkesa e mësimin në programin e studimit për personelin akademik Msc në Financë-bankë është e ndarë pothuaj në mënyrë të barabartë ndërmjet pedagogëve efektiv dhe me kontratë. Sipas dokumentacionit të dorëzuar nga institucioni në lidhje me ngarkesën vihet re që:

Në vitin akademik **2016-2017**, pedagogët efektiv(PAE) kanë kryer 645 orë ose **51%** të ngarkesës, pjesën tjetër të orëve 615 orë, **49%** të ngarkesës mësimore të programit të studimit e kanë kryer pedagogët me kontratë (PAK).

Ndërsa në vitin akademik **2017-2018** është e kundërta, **49%** të ngarkesës e kanë përballuar pedagogët efektiv(PAE) ndërsa **51%** të saj pedagogët me kontratë(PAK).

Personeli akademik që jep mësim në programin e studimit Msc në Financë-bankë, është i përbërë nga pedagogë me grada/tituj shkencorë dhe me kualifikime profesionale. Pedagogët me kontratë me një përjashtim janë të gjithë të kategorisë Profesor, gjë që shpjegohet edhe pse mbajnë atë pjesë të

ngarkesës. Megjithatë për të pasur qëndrueshmëri afatgjatë në mësimdhënie në këtë program studimi mendojmë se ky program studimi do të duhej të përballohej me shumë nga pedagogët efektiv. Përsa i përket personelit administrativ, të dhënat nga institucioni nuk janë determinuese. Kjo sepse në tabelën 1, në RVB paraqiten nga 13 persona si personel administrativ për cdo departament, ndërkohë që në tabelën 4 të RVB specifikohet se personeli Administrativ është 13 me ndarje PAE =8 dhe PAK= 5. Gjatë vizitës në institucion, na u saktësua se në tabelën 1 janë përshkruar pozicionet që ata mbulojnë sepse janë 13 në total. Nga këto të dhëna duket një mbingarkesë e Personelit Administrativ. Të dhënat për Personelin Administrativ janë ofruar nga institucioni vetëm për vitin 2017-2018.

Përsa i përket raporteve Personel akademik /student, për vitin aktual ky raport është $15/270 = 0.055$, ose me raport të përmbysur do të kishim: Student/Personel akademik $270/15 = 18$ studentë për cdo pedagogë.

Personel administrativ/student $13/270 = 0.048$, ndërkohë që raporti i përmbysur student /personel administrativ është $270/13 = 20.769$. kjo do të thotë se për cdo 20-21 student ka 1 personel administrativ. Por ky raport nuk është domethënës meqenëse numri 13 i personelit administrativ është në nivel institucioni dhe jo programi mësimor.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat,**

Në programin e studimit Msc në Financë-bankë në vitin aktual japin mësim gjithsej 15 pedagogë nga të cilët 8 janë efektiv(PAE) dhe 7 pedagogë janë me kontratë(PAE). Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programin e studimit Master Shkencor në Financë-bankë për vitin 2017-2018 përbën 53% (8 nga 15) të personelit të angazhuar për realizimin e programit të studimit.

Sipas dokumentit: Plan mësimor 2012-2016, si dhe nga tabelat: Ngarkesa mësimore për programin sipas pedagogëve dhe departamenteve për vitet akademike 2016-2017 dhe 2017-2018, vihet re që numri i personelit akademik vecanërisht atij efektiv, per programin e studimit Msc në Financë-bankë ka ardhur në rritje. Në dy vitet e para të ofrimit të këtij programi studimi numri i pedagogëve ka qenë 4 pedagogë efektiv dhe numri i pedagogëve me kontratë ka qenë 8, në vitin 2012-2013 dhe 7 pedagogë me kontratë në vitin akademik 2013-2014. Pas vitit 2014 vihet re që institucioni ka shtuar pedagogët efektiv duke ulur numrin e pedagogëve me kontratë. Kështu në vitin akademik 2015-2016 numri i pedagogëve efektiv(PAE) është bërë 5 ndërsa i pedagogëve me kontrate(PAK)

është 6. Në dy vitet e fundit ka vazhduar rritja e numrit të pedagogëve efektiv dhe të jashtëm ku Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programin e studimit Master Shkencor në Financë-bankë për vitin 2017-2018 përbën **53%**. (Tabela 4 në Anekse).

Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinator/ët e programit të studimit
Programi i studimit ka Këshillin Shkencor të përbërë nga profesorë. Koordinator i programit të studimit Msc në Financë-bankë, është autoriteti bashkërendues i veprimtarisë së programit të studimit në Fakultetin e Shkencave Ekonomike dhe kujdeset për realizimin e misionit të programit të studimit. Departamenti Financë, Bankë dhe Kontabilitet në bashkëpunim me Koordinatorin e programit të studimit harton rregulloren e brendshme të ciklit të studimit dhe strategjinë e programit të studimit. (Tabela 3).

Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre

Nga sa vihet re nga tabela 4 tek Anekset, të gjithë pedagogët që japin mësim në këtë program studimi janë me grada/ tituj. Numri i Profesorëve nuk ka qenë i qëndrueshëm, duke qenë se ata i përkasin pedagogëve me kontratë. Numri i pedagogëve efektiv që kanë gradë shkencore dhe titullin akademik Profesor i Asociuar dhe i pedagogëve vetëm me gradë shkencore Doktor ka ardhur në rritje, si rrjedhojë e politikës që ka ndjekur institucioni për të rekrutuar pedagogë me tituj dhe grada shkencore gjë që është shumë pozitive për procesin kërkimor shkencor.

Të dhënat sipas seksit

Tabela në vijim jep të dhënat sipas seksit. Personeli akademik që zhvillon mësimin në këtë program studimi ka ndarje gjinore **46% femra dhe 54% meshkuj**.

Gjinia	Femërore	Meshkullore
Personelit Akademik Efektiv	4	4
Personelit Akademik me Kontratë	3	4
Gjithsej	7	8

Të dhëna sipas moshës së personelit

Nga verifikimi i tabelave të RVB vihet re që si pedagogët efektiv ashtu edhe pedagogët me kontratë edhe që i përkasin këtij programi studimi janë në pjesë të madhe mbi 56 vjec.

Të dhëna sipas moshës (sipas RVB)

Personeli sipas titujve /gradave	Numri i PAE me moshë:				
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)
Profesorë	0	0	0	0	0

Profesorë të As.	0	0	1	1	1
Dr/PhD	1	0	1	3	0
Pedagogë ne proces Dr	0	0	0	0	0
Asistentë me Msc	0	0	0	0	0
Personeli Administrativ	4	2	2	0	0

Personeli sipas titujve /gradave	Numri i PAK me moshë:				
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)
Profesorë	0	0	1	2	0
Profesorë të As.	0	0	1	2	0
Dr/Phd	1	0	0	0	0
Pedagogë ne proces Dr	0	0	0	0	0
Asistentë me Msc	0	0	0	0	0
Personeli Administrativ	0	4	1	0	0

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Nga vizita në institucion në Zyrën e Burimeve Njerëzore u verifikuan dosjet e personelit. Kontratat janë të ndërtuara komform ligjeve në fuqi dhe paraqesin të drejtat dhe detyrime të palëve. Dosjet përmbanin kontratat e cdo viti në rast se kontrata ishte një vjecare, dhe kjo ndodhte me pedagogët që ende nuk kanë marrë gradë shkencore dhe pedagogë mbi moshën e pensionit. Për pedagogët me të paktën gradën shkencore “Doktor”, kontrata është pa afat.

Dosja pedagogut përmbante:

- Kurrikulum Vitae të pedagogut;
- Fotokopje ID
- Fotokopje të noterizuara të diplomës së shkollës së lartë (jo në të gjitha rastet të noterizuara)
- Fotokopje të titujve (Postmaster, PHD);
- Fotokopje të panoterizuar të kualifikimeve të tjera (ne rast se ka)
- Kontratat ishin edhe të viteve të mëparshme në rast kur ishte personel me kontratë

Në dosje nuk ishin dokumentat e mëposhtme:

- Libreze shëndetësore dhe raport mjekësor që vërteton që personi është i aftë për punë.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Stafi ndihmës/administrativ është i rëndësishëm për procesin mësimor. Stafi ndihmës administrativ ndihmon në sigurimin e bazës materiale të nevojshme për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe kërkimor. Në institucion na u komunikua se stafi ndihmës ishte gjithmonë i gjendshëm për cdo nevojë për të plotësuar kushtet e nevojshme për procesin mësimor dhe institucioni kishte ndjekur

politikën e punësimit si staf ndihmës të studentëve të diplomuar. Nga vizita në institucion në Zyrën e Sekretarisë, ne konstatuam parregullsi në plotësimin e rregjistrave. Në kolonën e datës së diplomimit të studentëve të programit Msc në Financë-bankë ishte vendosur data e diplomimit të studentëve në Bachelor. Nga komunikimi me sekretaret konkludua se stafi i sekretarisë ka nevojë për trajnim.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

1. Stafi akademik dhe ngarkesa mësimore për Msc Financë Bankë 2016-2017
2. Stafi akademik dhe ngarkesa mësimore për Msc Financë Bankë 2017-2018

Nga 2 dokumentacionet e mësipërme, ka një mospërputhje me numrin e pedagogëve efektivë që zhvillojnë mësim në programin e studimit. Në RVB dhe nga Plani mësimor 2012-2016, rezulton se në vitet akademike 2016-2017 dhe 2017-2018 të jenë 7 pedagogë efektivë. Nga dy dokumentacionet shtesë të mësipërme rezultojnë 8 pedagogë efektivë përgjatë dy viteve të fundit, është përfshirë edhe emri i kordinatores dhe ka ngarkesë mësimore në këtë program.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Personeli akademik është përgjegjës për hartimin e kurrikulave por edhe zbatimin e tyre në procesin mësimor.</p> <p>Personeli ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit ndihmon në mbarëvajtjen e procesit mësimor nëpërmjet plotësimit të bazës material dhe kushteve të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor.</p> <p>Sipas RVB, arritja e mbarëvajtjes së procesit mësimor dhe e objektivave të këtij programi studimi është në kohërencë me strategjinë e institucionit, meqenëse ky program është në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Sipas Statutit dhe rregullores së Institucionit është e drejta dhe përgjegjësia e departamenteve të hartojnë kurrikulat. Ky program studimi ofrohet nga departamenti i Financë Bankës ku edhe merren vendimet në lidhje me hartimet e kurrikulës, e cila përcaktohet pas debatit shkencor të stafit akademik.</p> <p>Departamentet kanë përgjegjësinë për të evidentuar nevojat për personel të ri akademik në varësi të</p>

	<p>ngarkesës mësimore. Departamenti në varësi të nevojës parashtron edhe kriteret për rekrutimet e reja që janë në varësi të lëndës për të cilën ka lindur nevoja.</p> <p>Personeli akademik është me kohë të plotë dhe të pjesshme. Procedura e rekrutimit kryhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p>Nga verifikimi i kontratave gjatë vizitës u verifikua se stafi njihet me ngarkesën mësimore, të drejtat dhe detyrimet.</p>
<p>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Institucioni ka rpecodura të përcaktuara në lidhje me rekrutimin e personelit. Pas evidentimit të nevojës për staf të ri, departamenti i drejtohet dekanatit dhe dekani rektorit. Njoftimi bëhet në web të institucionit www.umsh.edu.al, në media vizive dhe në kompani rekrutuese.</p> <p>Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programin e studimit</p> <p>Për programin Master Shkencor në Financë Bankë në vitin aktual personeli akademik efektiv përbën 53% (8 nga 15) të personelit të angazhuar për realizimin e programit të studimit.</p> <p>Për sa i përket ngarkesës, 49% të ngarkesës e kanë përballuar pedagogët efektiv(PAE) dhe 51% të saj pedagogët me kontratë(PAK).</p> <p>Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit. Vlerësimi i personelit akademik ka në bazë të tij vlerësimin për procesin e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor.</p> <p>Cdo pedagog në fund të vitit plotëson një formular në të cilin paraqet si ngarkesën mësimore ashtu edhe punën kërkimore shkencore e cila konvertohet në orë mësimore.</p> <p>Për procesin e vlerësimit të pedagogëve është një element i rëndësishëm edhe anketimi i studentëve në fund të cdo semestri për lëndët e zhvilluara gjatë atij semestri.</p> <p>Gjatë vizitës na u tha se procesi i vlerësimit përfshinte edhe ndjekjen e procesit mësimor gjatë zhvillimit nga përgjegjësat e departamenteve/profesorët.</p> <p>Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante. Gjatë vizitës institucioni na paraqiti procedurën e fundit të rekrutimit në fillim të vitit</p>

	akademik 2017-2018.
Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.	
<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p>	<p>Programi i studimit Msc në Financë-bankë, ofrohet nga Departamenti i Financë, Bankë dhe Kontabilitet. Përgjegjësja e këtij departamenti ka gradën shkencore Doktor.</p> <p>Programi i studimit Msc në Financë-bankë ka Këshill shkencor, kordinatore e të cilit gëzon titullin “Profesor i asociuar”.</p>
<p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>Në këtë program studimi “Master i Shkencave”, titullarët e lëndëve mbajnë të paktën gradën shkencore “Doktor”.</p> <p>Sipas tabelës së paraqitur në pjesën përshkruese, në këtë program studimi për vitin akademik 2017-2018, japin mësim 3 pedagogë me titullin “Profesor”, 6 pedagogë me titullin “Profesor i Asociuar” dhe 6 pedagogë me gradën shkencore “Doktor”.</p> <p>Rektori, zv/rektorët, dekani, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i programit, janë të punësuar me kohë të plotë pranë Universitetit “Mesdhetar të Shqipërisë” që ofron këtë program studimi.</p> <p>Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>
Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të</p>	<p>Studentët e Masterit Shkencor përgatisin Mikrotezë në përfundim të studimeve dhe kryejnë praktikë mësimore. Cdo pedagog mbikëqyr maksimumi 10 studentë (sipas RVB), gjë që plotësohet nga institucioni nisur nga një numër jo shumë i lartë i studentëve.</p> <p>Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”, janë po ata pedagogë që japin mësim në këtë program dhe rrjeshimisht kanë të paktën gradën shkencore “Doktor”.</p>

natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.

Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.

Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.

Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.

Pedagogët që japin mësim në këtë program studimi kanë të paktën gradën shkencore "Doktor" që tregon nivelin e tyre në drejtim të kërkimit shkencor. Disa nga pedagogët që japin mësim dhe ofrojnë si mësimdhënien ashtu edhe ekspertizën e tyre si udhëheqës të studimeve kërkimore janë specialist të njohur në fushat përkatëse, të financë dhe bankës. Megjithatë të gjithë pedagogët nisur nga CV e tyre kanë njohuri si teorike ashtu edhe kërkimore në finance dhe bankë, të nevojshme për rhartimin e tezës përfundimtare.

Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.

Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;

Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.

Stafi ndihmës administrativ ndihmon në sigurimin e bazës materiale të nevojshme për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe kërkimor.

Gjatë vizitës në institucion na u komunikua se stafi ndihmës ishte disponibël për çdo nevojë për zhvillimin normal të procesit mësimor dhe institucioni kishte ndjekur politikën e punësimit si staf ndihmës të studentëve të diplomuar.

Studentët kryejnë orët e nevojshme në laboratorin e Informatikës dhe në çdo sallë ku zhvillohen leksione dhe seminare gjendet sistemi audio-viziv. Për realizimin e programit mësimor të institucioni ka angazhuar në mënyrën më optimale personeli akademik dhe personel ndihmës.

Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;

Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.

Ngarkesat mësimore gjenden të pasqyruara në planet mësimore për çdo vit akademik.

Në këto plane jepen pedagogët përkatës për çdo lëndë dhe ngarkesa mësimore e secilit.

Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në këtë program studimi vlerësohet me orë mësimore.

Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.

Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;

Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;

Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.

Gjatë vizitës në Zyrën e Burimeve njerëzore u verifikuan dosjet e personelit akademik që jep mësim në programin e studimit. U verifikuar kontratat dhe elementet përbërës të dosjeve. Dosjet me CV dhe të gjithë aktivitetin akademiko-profesional gjenden në departament.

Institucioni ka vënë në dispozicion të gjithë informacionin e plotë për secilin pedagog nëpërmjet dokumentacionit që kanë dërguar.

Në planet mësimore të cdo viti akademik që nga koha e akreditimit të parë, institucioni disponon emrat e pedagogëve përgjegjës për cdo lëndë. Sipas RVB institucioni disponon edhe listën e plotë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ.

Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik në media vizive, web të institucionit, etj.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Personeli akademik harton kurrikulat dhe zhvillon procesin mësimor. Personeli ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit ndihmon në mbarëvajtjen e procesit mësimor nëpërmjet plotësimit të bazës material dhe kushteve të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor.
2. Departamenti në varësi të nevojës parashtron edhe kriteret për rekrutimet e reja që janë në varësi të lëndës për të cilën ka lindur nevoja. Personeli akademik është me kohë të plotë dhe të pjesshme. Procedura e rekrutimit kryhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Njoftimet për vënde vakante bëhen në ëeb të institucionit, në media vizive dhe ne kompani rekrutuese.
3. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë (efektiv) në programin e studimit Master Shkencor në Financë-bankë përbën **53% (8 nga 15)** të personelit të angazhuar për realizimin e programit të studimit.
4. Personeli akademik vlerësohet në cdo fund viti. Në bazë të vlerësimit është procesi i mësimdhënies dhe i kërkimit shkencor. Në këtë program studimi “Master i Shkencave”, titullarët e lëndëve mbajnë të paktën gradën shkencore “Doktor”.
5. Përgjegjëse e programit të studimit Msc në Financë-bankë, ka gradën shkencore Doktor. Udhëheqësit e Mikrotezave dhe praktikave kanë të paktën gradën shkencore “Doktor”, dhe janë specialist të njohur në fushat përkatëse që ata ofrojnë si mësimdhënien ashtu edhe ekspertizën. Ngarkesat mësimore gjenden të pasqyruara në planet mësimore për çdo vit akademik.
6. Të gjithë drejtuesit e institucionit që kanë lidhje me programin e studimit janë të punësuar me kohë të plotë pranë Universitetit “Mesdhetar të Shqipërisë”.
7. Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit.

Standardet plotësohen kryesisht. Kjo sepse:

1. Personeli akademik efektiv në programin e studimit Master Shkencor në Financë Bankë në aspektin numerik përbën **53%** të personelit të angazhuar për realizimin e programit të studimit (standarti kërkon 70%), ndërkohë që PAE mbulon vetëm **49%** të ngarkesës në vitin e fundit.

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” ushtron aktivitetin e tij akademiko-shkencor në një godinë të pozicionuar në një nga zonat kryesore të kryeqytetit në unazën e Tiranës. Godina ndodhet pranë stacioneve të autobusëve publik duke e bërë të lehtë lëvizjen e studentëve. UMSH ndodhet në një zonë studentore sepse ndodhet pranë institucioneve të tjera të arsimit të lartë publik dhe privat.

Godina ku ushtrohet aktiviteti është e ndërtuar me infrastrukturë bashkëkohore dhe e pajisur me teknologji të fundit të zhvillimit të procesit mësimor shkencor. Klasat e seminareve, sallat e leksioneve si dhe zyrat e pedagogëve kanë hapësira dhe kushte optimale për zhvillimin e orës së mësimit dhe aktivitete të tjera akademike. Në institucion ka zyra të mjaftueshme për stafin ndihmës edhe ato me kushte dhe teknologji bashkëkohore. Biblioteka ndodhet në katin 0 dhe përveç titujve që ofron në ambjentet e saj, ka akses online në faqen elektronike “www.questia.com” duke ju ardhur kështu në ndihmë pedagogëve dhe studentëve në punimet e tyre shkencore.

Institucioni ka instaluar internetin Wireless me shërbim interneti 24 orë, i cili është në funksion të studentëve dhe stafit në të gjithë hapësirat e universitetit. Në bibliotekë ofrohet edhe shërbimi i fotokopjimit të materialeve në rast kërkese nga studentët. Në ambjentet e UMSH është ngritur edhe një Bar dhe fast food, i cili ju ofron studentëve jo vetëm mundësinë e konsumit të produkteve por edhe një ambjent shplodhës.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit (sipas RVB)

- Salla për leksione 6
- Klasa për seminare 15
- Salla për aktivitete promovuese 1
- Laboratorë informatike 3
- Salla interneti 1
- Salla për bibliotekë 1
- Mjedis për fotokopjime, librari etj. 1
- Zyrë informacioni për studentët 1
- Nyje hidrosanitare 53

Mjediset për stafin:

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin 7
- Zyra për sekretarinë mësimore 1
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore 8
- Zyra për personelin akademik 2

Të dhënat për infrastrukturën janë bazuar në RVB me ndonjë ndryshim, të cilin e kemi konstatuar gjatë takimit, si sallë biblioteke apo zyre sekretarie që ishin përkatësisht nga 1.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>UMSH gjendet në një zonë të kryeqytetit ku ndodhen edhe institucione të tjera universitare, gjë që është sa pozitive për shkak se studentët janë pranë shërbimeve të ndryshme që ofrohen nga operatorë privat pranë universiteteve, po ashtu është edhe negative sepse ka konkurrencën shumë pranë.</p> <p>Godina ku janë vendosur mjediset e universitetit është relativisht e re dhe ka jo më pak se 6 vjet që është në dispozicion të këtij universiteti.</p> <p>Programi i studimit ofrohet në të njëjtën godinë. Godina ku zhvillohet programi i studimit Msc në Financë - bankë, garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e programit të studimit.</p>
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion në takim me studentët, ata na komunikuan se tekstet mësimore dhe literatura ndihmëse vihej gjithmonë në dispozicion nga Institucioni.</p> <p>Institucioni ka mundur edhe librarinë on line nëpërmjet shfrytëzimit online të faqes elektronike “ëëë.questia.com”. Studentët dhe stafi akademik kanë akses në këtë faqe elektronike.</p> <p>Institucioni vuri në dispozicion të grupit të punës listën e titujve të botimeve që ndodheshin në bibliotekë. Lista e titujve është e pasur, por nga vizita në institucion u vu re se tirazhi për cdo titull është i pamjaftueshëm për të gjithë studentët, vecanërisht literaturat bazë dhe ndihmëse.</p> <p>Nga ana procedurale biblioteka pasurohet cdo vit me tituj të rinj duke marrë në konsideratë kërkesat e pedagogëve për titujt që i vijnë në ndihmë studentëve për procesin mësimor.</p> <p>Në bibliotekë ndodhen raporte periodike si psh nga Banka e Shqipërisë, por të disa viteve më parë, dhe nuk kishte një marrëveshje institucionale për përditësimin e</p>

tyre.

UMSH ka lidhur marrëveshje me një sërë organizma të ndryshme institucionale vendore dhe qendrore por nga përmbajtja e marrëveshjeve nuk ekziston si pikë marrëveshjeje ofrimi i publikimeve periodike të institucioneve. Mendojmë se duhet të shtohet kjo pikë.

Ky program është Master shkencor dhe si i tillë kërkon edhe punime shkencore në një nivel të lartë të studentëve dhe gjetja e të dhenave të përditësuara është thelbësore për ta.

Departamenti në fund të çdo viti akademik diskuton lidhur me nevojat për ndryshime dhe pasurim të fondit të bibliotekës, në funksion të procesit mësimor, kërkimit dhe punës shkencore. Gjatë vizitës na u tha se për pasurimin e bibliotekës me libra të rinj duke i blerë apo edhe nëse ka kërkesë për botim nga pedagogët, fondet vihen në dispozicion nga institucioni pa asnjë pengesë.

Nga vizita në institucion u njoftuam se orari i bibliotekës është 8.30-20.30. Ky orar është shumë i përshtatshëm për studentët e Masterit Shkencor në Financë-bankë të cilët zhvillojnë mësim nga e marta në të shtunë në oraret 17.00-21.00.

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.

Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;

Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;

Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;

Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.

Institucioni ka sasi të mjaftueshme me laboratorë, klasa, zyra, e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për studentët pedagogët dhe stafin ndihmës, për realizimin e programit të studimeve.

Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit. Klasat janë të pajisura me sistem audioviziv komunikimi. Sallat e leksioneve janë të ndërtuara në formë amfiteatri.

Institucioni ka laboratorë me PC për studentët, por ky program studimi nuk ka në planin e tij mësimor laboratorë.

Praktikat profesionale zhvillohen në insitucionet të ndryshme publike dhe private bazuar në marrëveshje bashkëpunimi dhe mirëkuptimi ndaj studentët nuk shfrytëzojnë laboratorët për këtë qëllim.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Institucioni ka një vendndodhje të përhershme. Godina ku zhvillohet programi i studimit Msc në Financë - bankë, garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e programit të studimit.
2. Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse bashkëkohore. Institucioni ka

mundësuar edhe librarinë on line.

3. Institucioni ka sasi të mjaftueshme me laboratorë, klasa, zyra, e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për studentët pedagogët dhe stafin ndihmës, për realizimin e programit të studimeve.

Standardet plotësohen plotësisht.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” është projekt i OJF “Qendra Mesdheu”. OJF “Qendra Mesdheu” është regjistruar me Vendim Nr. 411 datë 06.07.2007 të Gjykatës së Rrethit Tiranë si person juridik dhe si objekt të aktivitetit ka realizimin e ushtrimit të aktivitetit në fushën e arsimit të lartë privat, dhe rezulton i regjistruar në Rregjistrin e Organizatave Jofitimprurëse, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Tiranës. (Ligji Nr. 8788, “Për Organizatat Jo Fitimprurëse” dhe Ligji nr. 8789, “Për Regjistrimin e Organizatave Jo Fitimprurëse”). Referuar Statutit, Bordi i Administrimit është organi më i lartë Kolegjal Administrativ i cili siguron përmbushjen e misionit, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të Institucionit. Bordi i Administrimit garanton qëndrueshmërinë financiare të institucionit dhe miraton paraprakisht planin buxhetor vjetor dhe afatmesëm. Bordi i Administrimit përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga veprimtaritë dhe mbikqyr shpërndarjen dhe përdorimin e burimeve financiare. Sipas RVB, Bordi i “Qendra Mesdheu” është autoriteti i cili emëron anëtarët e Bordit të Administrimit. Financimi, menaxhimi dhe administrimi i UMSH është i pasqyruar në Pasqyrat Financiare të tij. Institucioni ofron shërbime duke u fokusuar në misionin e tij dhe mban kontabilitet të rregullt sipas legjislacionit në fuqi. Burimi kryesor financiar janë të ardhurat nga tarifatat studentore. Burime dytësore institucioni i ka nga të ardhurat nga aktivitetet tregtare dhe nga grantet për kërkime dhe kontrata, këto të fundit shfaqen si burim të ardhurash vetëm në vitin 2017. Për vitin e fundit institucioni ka pasur si burime financiare 288,522,000 lekë dhe kosto për student 137,000 lekë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (**në përqindje**):
 - Grantet për kërkim **0.54%**
 - Konsulencat, shërbimet
 - Tarifatat për dhe gjatë shkollimit **98.34%**

- Sponsorizimet
- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)
- Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj) **1.12%**

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Zyra e Financë Kontabilitetit është përgjegjëse për menaxhimin financiar dhe zbatimin e politikës financiare të institucionit. Tabela në vijim është marrë nga RVB dhe tregon koston e studentit në vite si dhe gjithsej financimin që ka bërë institucioni në këto vite.

Pasqyra dinamike e koston për student 2011-2017 ne 000/ leke									
N R	Emertimi	Njësia	Vitet						Buxhet
			2011- 2012	2012- 2013	2013- 2014	2014- 2015	2015- 2016	2016- 2017	
1	Totali financimit	Lekë	98,039	104,016	121,875	162,819	215,443	254,137	288,522
2	Kostoja per student	Lekë /student	257	172	178	102	100	106	137

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	

Duf

AKU

Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;

Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;

Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.

Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” është projekt i OJF “Qendra Mesdheu” si rrjedhojë Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë” është pjesë e auditimit të OJF “Qendra Mesdheu”.

Në dokumentacionet e dorëzuara nga institucioni gjendet edhe Raporti i auditit të pavarur Croëe AL Shpk për vitin 2017 për OJF “Qendra Mesdheu”. Sipas këtij raporti janë audituar pasqyrat financiare.

Në RVB gjejmë tabelën e plotë të burimeve të financimit ku theksohet se është Zyra e Financë Kontabilitetit përgjegjëse për mbajtjen e dokumentacionit kontabël dhe hartimin e pasqyrave financiare vjetore të UMSH, sipas standarteve kombëtare të kontabilitetit, bazuar në Rregulloren e Organizimit të UMSH, neni 31.

Pasqyrat financiare të Institucionit janë transparente dhe pasqyrojnë me saktësi gjendjen financiare të tij, gjendje e cila jep siguri për vazhdimësinë e aktivitetit të institucionit.

Nga pasqyrat financiare shihet se nga viti 2012 deri në 2017, janë tarifat shkollore ato që zënë rreth 96% deri 99% të burimeve të financimit.

Burime të tjera financimi janë burime nga aktiviteti tregtar dhe grantet.

Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.

Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.

Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.

Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.

Institucioni (Zyra e Financë Kontabilitetit) harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.

Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen. Bordi i administrimit miraton raportin në fund të vitit, sipas Statutit.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë” është pjesë e auditimit të OJF “Qendra Mesdheu”. Pasqyrat

financiare të OJF "Qendra Mesdheu" auditohen nga ekspertë të jashtëm.

2. Nga pasqyrat financiare shihet se janë tarifatat shkollore ato që zënë rreth 96% deri 99% të burimeve të financimit, ndërsa burime të tjera financimi janë burime nga aktiviteti tregtar dhe grantet.
3. Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.

Standardet plotësohen plotësisht.

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Në shërbim të rritjes së cilësisë, institucioni ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të adoptuar politika dhe strategji të reja në lidhje me kriteret e cilësisë, si dhe rritjen e mëtejshme të standardeve të cilësisë. Funksionet e NJSBCZHK tashmë shihen nga ana e institucionit si një pjesë integrale e menaxhimit të procesit didaktik, por gjithashtu edhe si një instrument për rritjen e performancës. Në vazhdimësinë e zbatimit të reformave për standartet evropiane të Arsimit të Lartë, funksioni i NJSBCZHK është zhvilluar duke marrë një pozicion të ri në funksion të rritjes së vazhdueshme të cilësisë. Pranë Institucionit është ngritur Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave prej Janarit të vitit 2011. Kjo njësi përbëhet nga 7 anëtarë. Në fillimet e punës është ngritur si Komision i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. NJSBCZHK duhet të planifikojë organizimin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë të programeve të studimit dhe të vlerësimit institucional. NJSBCZHK vepron si një strukturë me veprimtari të pavarur, për të ofruar siguri objektive dhe këshillim, për të shtuar vlerën duke nxitur ndryshime që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e veprimtarive mësimore. NJSBCZHK ndihmon menaxhimin didaktik dhe jo vetëm, duke ofruar analiza, rekomandime, këshillime dhe informacione lidhur me veprimtaritë që ka vlerësuar. NJSBCZHK është organi kryesor që realizon anketimet për matjen e performancës së pedagogëve në procesin mësimor, për vlerësimin e infrastrukturës mësimore, për vlerësimin e punës me studentët dhe të sekretarisë mësimore. NJSBCZHK në bashkëpunim me rektoratin, dekanatin dhe Zyrën e burimeve njerëzore, realizon edhe pyetësorin për vlerësimin e pedagogëve, me anë të metodës së vetvlerësimit. Pyetësori përmban të dhëna kryesisht për cilësinë e mësimdhënies, mënyrës së mësimdhënies, etj. Raporti përfundimtar i NJSBCZHK përmban të dhëna edhe për raportin me studentët si dhe të dhëna për punën kërkimore shkencore, të cilat do të jenë pjesë e performancës së pedagogëve.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:
 - Sa anketime kanë bërë me studentët, 2 herë në vit
 - Sa studentë janë anketuar, 60% e studentëve aktiv
 - Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë, rreth - 25% e anketave
 - Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm, - Rekomandon detyra
 - Etj

Anketimet për vlerësimin e performancës së pedagogëve bëhen përpara provimit përfundimtar në fund të cdo semestri. Nga vizita në institucion dhe takimet me stafin dhe studentët na u komunikua që pyetësorët për këtë anketë realizoheshin përpara provimit të lëndëve. Studentët theksuan se nëse ata hasnin ndonjë problematikë në ndonjë lëndë të caktuar, nuk prisnin fundin e semestrit por komunikonin me tutorin apo përgjegjësit e njësive bazë ku identifikonin problematikën dhe ju jepej zgjidhje shume shpejt. Studentët u shprehën të kënaqur në lidhje me reagimin e shpejtë të institucionit.

Studentët anketohen 2 herë në vit, përpara sezoneve të provimeve. Në këto anketa marrin pjesë studentët që janë prezent dhe dëshirojnë të anketohen, përgjithësisht 60% e studentëve aktivë për vitin akademik, sipas RVB. Anketa përpunohet nga NJSBCZHK dhe përfundimet raportohen pranë dekanit dhe rektoratit. Në raport rekomandohen detyra të cilat do të ndiqen për zbatim nga strukturat drejtuese dhe nga NJSBCZHK.

- **Sa anketime kanë bërë me studentët**

Anketimet kryhen 2 herë në vit në të gjitha lëndët që zhvillohen gjatë vitit akademik, përkatësisht semestrave mësimore.

- **Sa studentë janë anketuar**

Anketimi kryhet para Sezoneve të rregullta të provimeve dhe në të marrin pjesë studentët që janë prezent dhe dëshirojnë të plotësojnë anketën. Ky numër zakonisht nuk është më i vogël se 60% të studentëve aktivë për vitin akademik.

- **Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë**

Përpunimi i anketimeve realizohet nga NJSBCZHK e cila përpunon rreth 25% të anketave të plotësuara të zgjedhura në mënyrë rastësore. Për lëndët të cilat ndiqen nga rreth 30 studentë, përpunohen të gjitha anketat e plotësuara. Për rastet kur numri i anketave të plotësuara është më i vogël se 25%, anketa nuk merret në konsideratë për t'u përpunuar.

- **Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm**

Për secilin nga proceset akademike që vlerësohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre NSBCZHK raporton pranë rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve. Njëherazi, rekomandon detyra, zbatimi i të cilave ndiqet nga ana e strukturave drejtuese dhe vetë NJSBCZHK. Shpesh rekomandimet kanë qënë një burim i rëndësishëm për të nxjerrë konkluzione mbi cilësinë e punës së secilit, në disa raste janë shoqëruar edhe me marrjen e masave konkrete ndaj pedagogëve të ndryshëm.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Në fokus të kontrollit të brendshëm të cilësisë janë: stafi akademik, stafi ndihmës mësimesh shkencor, stafi joakademik. UMSH ka hartuar Manual të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i cili është miratuar nga Rektori i Universitetit. NJSBCZHK në mënyrë periodike raporton dhe informon organet drejtuese në lidhje me rezultatet e kontrolleve të zhvilluara. Ky raportim bëhet në mënyrë konfidenciale për të gjithë stafin e UMSH. NJSBCZHK aktivitetin e saj e zhvillon sipas një plani kalendar të përvitshëm, në të cilin programohen kontrollet në sektorët apo proceset që i nënshtrohen kontrollit/vlerësimit e që shoqërohen me raportet me gjetjet përkatëse. Ndërkohë, në mënyrë periodike NJSBCZHK informon rektoratin, drejtuesit e fakulteteve, e përmes tyre në mënyrë konfidenciale të gjithë stafin e UMSH rreth rezultateve të kontrolleve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësisive të tij bazë dhe individëve në të ardhmen.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe zhvillimit të kurrikulave vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore – shkencore të Universitetit dhe harton Raportet përkatëse të Vlerësimit të Brendshëm. Këto raporte diskutohen në të gjitha njësitë e UMSH, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në kryerjen e këtyre veprimtarive në të ardhmen. Në nivel institucional përgjegjësinë për sigurimin e cilësisë së brendshme e ka Senati, i cili miraton planin strategjik. Rektori është përgjegjës për përpilimin e planveprimit të vetvlerësimit të cilësisë në nivel unieversiteti. NJSBCZHK operon sipas një plani kalendar të përvitshëm.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Në përbërje të NJSBCZHK ka jo vetëm staf akademik por edhe studentë duke bërë të mundur kështu njohjen me problematika të ndryshme. Nga vizita në institucion na u komunikua se një formë e kontrollit të cilësisë ishte edhe asistimi në auditorë gjatë mësimit të profesorëve të lëndëve për të ndjekur nga afër mënyrën e mësimdhënies.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

NJSBCZHK përgatit Raportin Vjetor të Vetëvlerësimit. Raportet e vlerësimeve përdoren si burim për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Në Raport NJSBCZHK -ja udhëzon njësitë bazë dhe kryesore lidhur me pikat e forta dhe dobësitë e tyre. Raporti përmban sugjerime përkatëse për

përmirësimin e veprimtarisë. Raporti shpallet publikisht. Propozimet e NJSBCZHK shqyrtohen nga organet dhe autoritetet drejtuese të institucionit dhe reflektohen në vendimmarrje konkrete.

Rezultatet e auditimit dhe vlerësimeve të jashtme

NJSBCZHK vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore- shkencore të Universitetit dhe harton raportet përkatëse të vlerësimit të brendshëm. Këto raporte diskutohen në të gjitha njësitë e UMSH me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Një nga format më të përdorura për vlerësimin e cilësisë në UMSH është Pyetëtori me studentët.

NJSBCZHK harton një raport vjetor të punës së saj, i cili i paraqitet dekanëve dhe Rektoratit. Raportet e hartuara nga NJSBCZHK përdoren si burim për përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë. Në bazë të këtij raporti merren informacionet mbi nevojën për përmirësim të cilësisë. Sipas rregullores Rektorati bënë vlerësimin e punës së NJSBCZHK, aprovon raportin dhe miraton programin e punës për vitin pasardhës. NJSBCZHK ka hartuar raport deri për vitin akademik 2016-2017, meqënëse viti akademik 2017-1018 nuk ka përfunduar ende.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësim për stafin

Formular i vlerësimit të pedagogëve

Relacion mbi rezultatet e anketimit studentor 2017

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <p>a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;</p> <p>b. Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;</p> <p>c. Pyetje konceptuale;</p>	<p>Institucioni ka Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe zhvillimit të kurrikulave, të përbërë nga 7 anëtarë. NJSBCZHK ka përdorur metodologji të caktuara, me instrumente matëse dhe vlerësuese të tilla si: pyetesorë, raporte të posaçme për pedagogët, kontrolle te procesit mësimor, relacion për përmbushjen e programit të lëndëve duke pasqyruar problemet e konstatuara, intervista me studentë etj.</p> <p>Në fund të çdo semestri, nëpërmjet pyetësorëve të përgatitur, studentët japin mendimin e tyre në lidhje me pedagogun dhe vlerësimin e lëndës.</p> <p>Kurrikula përmirësohet duke marrë për bazë rezultatet e vlerësimit nga personeli akademik dhe nga studentët. NJSBCZHK kryen sondazhe dhe intervista të studentëve në lidhje me përmirësimin e</p>

<p>d. Intervista; e. Etj.</p> <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <p>a. Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj);</p> <p>b. Dëgjime në auditor;</p> <p>c. Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;</p> <p>d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</p> <p>e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</p> <p>h. Etj</p>	<p>kurrikulës.</p> <p>Metodat e tërthorta të vlerësimit janë implementuar me anë të pyetësorit të studentit ku ka patur seksione mbi:</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, • Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; • Pyetje konceptuale; • Intervista; <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Dëgjime në auditor; • Vlerësimi me pikë;
	<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët • Vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës <p>Institucioni organizon pyetsor 1-2 herë në vit me studentët e programit të studimit. Studentët marrin pjesë me dëshirë në këtë pyetësor. Në rastin kur vihet re një numër i vogël studentësh pjesmarrës, përpunimi i të dhënave bëhet i vështirë.</p> <p>Në fund të cdo semestri, pedagogët përpilojnë një relacion për përmbushjen e programit të lëndës, problemet e konstatuara, me sygjerimet dhe rekomandimet përkatëse. Këto përfundime analizohen në përputhje me departamentet për përmirësimin e kurrikulës për vitin pasardhës akademik. Në kuadër të sigurimit të cilësisë, janë organizuar grupe kontrolli për efektivitetin e procesit mësimor. Mbajtja e dokumentacionit si regjistrat, detyrat e studentëve, provimet etj janë një mënyrë tjetër e kontrollit të cilësisë.</p>
<p>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>UMSH përgatit dhe shpërndan në formën e një raporti vlerësimet periodike mbi cilësinë, i cili u vihet në dispozicion strukturave drejtuese por edhe pedagogëve, sikurse dhe aktorëve të tjerë të interesuar në formën e broshurave promovuese të programeve dhe cilësisë që ato ofrojnë.</p> <p>Këto raporte dhe broshurat e programeve janë pjesë e diskutimit/prezantimit në nivel rektorati sikurse</p>

	dhe në nivel departamenti.
Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>NJSBCZHK përgatit Raportin Vjetor të Vetëvlerësimit. Raportet e vlerësimeve përdoren si burim për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Në Raport NJSBCZHK-ja udhëzon njësitë bazë dhe kryesore lidhur me pikat e forta dhe dobësitë e tyre. Raporti përmban sugjerime përkatëse për përmirësimin e veprimtarisë akademike; mësimdhënie, performancën e programit me tregun. Raporti shpallet publikisht.</p> <p>Propozimet e NJSBCZHK shqyrtohen nga organet dhe autoritetet drejtuese të institucionit dhe reflektohen në vendimmarrje konkrete.</p> <p>Mbështetur në pyetësorët e studentëve veçanërisht tek opinioni i shfaqur nga studentët që ndjekin programin, institucioni programon politika dhe ndërmerr masa për zhvillimin e mëtejshëm të programeve të studimit, për të reflektuar në to zhvillimet bashkëkohore me karakter teorik si dhe kërkesat e tregut të punës lidhur me aspektin praktik.</p>
Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë është akredituar institucionalisht në vitin 2012.</p> <p>Aktualisht funksionon si universitet në bazë të Urdhrit nr. 278, datë 19.05.2017 të MARS.</p> <p>Institucioni i ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve.</p> <p>Institucioni nëpërmjet njësisë së sigurimit të cilësisë, përcakton politika dhe plane konkrete për vlerësimin e mbarëvajtjes së programit të studimit.</p> <p>Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë, kryesisht cilësinë e mësimdhënies duke përgatitur:</p> <p><i>Pyetësorin për studentet;</i></p> <p><i>Pyetësorin për Pedagogët</i></p> <p><i>Kalendari i kontrollit të brendshëm të cilësisë.</i></p>

Relacioni per realizimin e programeve te lëndëve dhe plotësimi nga çdo pedagog

Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme si: pyetesorë, raporte të posaçme për pedagogët, kontroll te procesit mësimor, relacion për përmbushjen e programit të lëndëve duke pasqyruar problemet e konstatuara, etj. Ndërkohë konferencat studentore dhe konferenca kombëtare të organizuara nga departamentet shprehin qarte rëndësinë e kërkimit shkencor.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” i jep rëndësi sigurimit të cilësisë së brendshme. Pjesë e strukturës së institucionit është Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave.
2. Institucioni ka të hartuar në mënyrë të qartë politikën e procedurës së vlerësimit periodik. NJSBCZHK është organi kryesor që realizon anketimet për matjen e performancës së pedagogëve në procesin e mësimor, për vlerësimin e infrastrukturës mësimore, për vlerësimin e punës me studentët dhe të sekretarisë mësimore.
3. Për vlerësimin e cilësisë Institucioni përdor metodën e tërthortë të anketimit të studentëve dhe metodën e drejtpërdrejtë të dëgjimit në auditor të pedagogëve, etj..
4. Në mënyrë periodike raportet e hartuara nga NJSBCZHK raportohen në organet drejtuese, analizohen dhe vendoset për planveprim të mëtejshëm për cdo rritje të cilësisë së brendshme të nevojshme.

Standardet plotësohen plotësisht.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Programi i studimit Master i Shkencave në Financë -bankë, ofrohet nga UMSH për të gjithë studentët që zotërojnë diplomë të ciklit të parë Bachelor. Njohuritë e ofruara përkohë me njohuritë e fituara nga studentet në aspektin teorik dhe praktik, gjatë studimeve të programit Bachelor.

Programi Master i Shkencave i orienton dhe mëson studentët për kërkim shkencor të thelluar si dhe i aftëson për të zotëruar dije dhe aftësi të mirëfillta profesionale në fushën e financës.

Programi i studimit në vetëvete, ka si qëllim ti pajisë studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale me qëllim që tu shërbejnë në tregun e punës por edhe në të ardhmen duke qenë të aftë të zgjerojnë njohuritë e marra si gjatë zhvillimit të programit edhe në vazhdimësi. Pas përfundimit me sukses të programit Master i Shkencave në Financë-bankë, studentet kanë krijuar baza të forta njohurish për të vazhduar më tej ciklin e tretë të studimeve, atë të Doktoratës. Në përfundim të këtij programi njohuritë përfshijnë aftësimin e studentëve për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve për të qënë të përgatitur për ciklin e progameve të Doktoratës.

Programi i studimit është hartuar në përputhje me planin e tij mësimor. Studimet në këtë cikël realizohen me 120 kredite (ECTS) dhe zgjatja normale e tyre është 2 (dy) vjet, 4 semestra. Plani mësimor është i ndërtuar me rë në auditor dhe orë jashtë auditorit, orë të pavarura, ku këto të fundit zënë edhe peshën më të madhe të orëve. Të gjithë syllabuset kanë të përcaktuar literaturat bazë dhe ndihmëse, të cilat janë literatura bashkëkohore dhe mundësojnë formimin e studentëve në Financë - bankë. Në përfundim të programit të studimeve të ciklit të dytë studenti pajiset me diplomë “Master i shkencave”.

Objektivat e programit të studimit përfshijnë:

- Studimin e ekonomisë së biznesit, duke e fokusuar vëmendjen veçanërisht në mjetet konceptuale, kompleksitetin dhe realitetin dinamik të kompanive e bizneseve.
- Njohjen dhe përdorimin potencial të informacionit që rrjedh nga modeli i financës dhe bankës, për të hetuar nëpërmjet teknikave të ndryshme të analizave, rezultatet e aktivitetit ekonomik nën një aspekt ekonomik, financiar dhe pasuror;
- Përvetësimin e parimeve dhe kriterëve për formimin dhe prezantimin e buxheteve të sipërmarrjeve individuale dhe të grupeve të biznesit dhe aspekte të tjera të funksionit administrative, të kontrollit të brendshëm dhe studimin e kushteve të zhvillimit të biznesit;
- Përvetësimin e metodave të analizës sasiore për vendimmarrjen strategjike e operacionale

Programi i studimit Msc Financë-bankë është ndërtuar në përshtatje me kërkesat e Kartës së Bolonjës. Programi është ndërtuar në mënyrë të tillë që të përgatisë specialistë në financa dhe institucione financiare, të aftë të punojnë në biznese të ndryshme. Ky program është përshtatur me aktualitetin shqiptar por pa pasur një studim mbi nevojat e tregut të punës. Ky program i jep njohuri të mjaftueshme studentëve për të qënë të gatshëm për tu ofruar në tregun e punës por gjithashtu i jep mundësi atyre të vazhdojnë studimet e tyre në ciklin e tretë. Ky program studimi nuk ndjek një model apo shkollë të përcaktuar. Për ndarjen e lëndëve/moduleve sipas veprimtarive formuese departamenti është bazuar në Udhëzimin Nr.15, datë 04.04.2008 ‘Për organizimin e studimeve në IAL’ si dhe në Udhëzimin Nr.11, datë 28.02.2011 “Për procedurat dhe dokumentacionin për hapjen

e një Institucioni Privat të Arsimit të Lartë, Programeve të reja të studimit universitar në ciklin e parë dhe ciklin e dytë, programeve të studimit jo universitare, të natyrës profesionale, si dhe procedurat për pezullimin dhe revokimin e licencës”. **Duhet të theksojmë se për ndarjen e lëndëve/moduleve sipas veprimtarive formuese departamenti duhet të mbështetet në VKM nr 41, dt 24.01.2018, ku programet Msc organizohen në 5 disiplina. Kjo mbetet si objektivi për tu realizuar në vitet e ardhshme.**

Programi Msc Financë-bankë organizohet në 6 kategori disiplina (duhet të kemi parasysh që VKM nr. 41 dt 24.01.2018 bën një organizim në 5 kategori). Disiplinat mësimore dhe aktivitetet e tjera formuese të programit janë të organizuara në këto kategori:

Organizimi i çdo programi studimi (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor
- 1 ECTS 25 orë mësimore punë të studentit
- 1 orë mësimore 50'

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit për:

- Leksionet 12 orë në auditor dhe 13 orë punë e pavarur e studentit
- Seminare/Ushtime 11 orë në auditor dhe 14 orë punë e pavarur e studentit
- Seminare/Detyra 10 orë në auditor dhe 15 orë punë e pavarur e studentit
- Praktikën Profesionale 21 orë në auditor dhe 4 orë punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar 1 orë në auditor dhe 24 orë punë e pavarur e studentit

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi i studimit Master i Shkencave në Financë-bankë, është licensuar në bazë të Urdhërit nr. 482 datë 03.10.2011 të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës dhe Akredituar me Urdhërin nr. 291 datë 11.07.2012. Programi Master i Shkencave në Financë-bankë i orienton studentët për një edukim cilësor të qëndrueshëm me anë të mësimdhënies, kontributit në kërkim shkencor të thelluar, përdorimit të arritjeve më të mira dijes dhe të shkencës, si dhe partneriteteve me tregun e punës dhe atyre ndërkombëtare, si dhe i aftëson ata për të zotëruar dije dhe aftësi të mirëfillta profesionale në fushën e financës. Programi i studimit ka si qëllim formimin e ekspertëve dhe specialistëve të mirëfilltë në fushën e financave, bankave, sigurimeve dhe institucioneve të tjera financiare me anë të formimit teorik dhe praktik të studentëve në fushën e drejtimit të kontabilitetit, menaxhimit financiar, menaxhimit dhe teknikave bankare, auditimit, pasqyrave financiare, etj.

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë.

Në Tabelën 7 në Aneks jepen Planet mësimore nga viti 2012-2013 deri në vitin 2017-2018.

Plani mësimor nuk ka ndryshuar në vite, është i njëjti me planin e licensuar. Në planin mësimor është i përcaktuar viti dhe semestri që do të zhvillohet secila lëndë. Në planin mësimor janë detajuar orët e leksioneve, seminareve dhe krediteve ECTS sipas cdo forme të mësimdhënies.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës Tabelat 7,8,8/1ne Aneks

Në tabelat në Aneks ndodhen të dhënat për personelin akademik të lidhur me planet mësimore. Nga të dhënat e personelit akademik që lidhen me planet mësimore sipas dokumentacionit të dorëzuar nga institucioni vihet re që të gjithë pedagogët kanë gradën Dr, Prof.asoc. ose Prof. Dr. Fillimisht titullarët e lëndëve kanë qenë në një pjesë të konsiderueshme pedagogë me kontratë dhe më pak pedagogë efektiv. Numri i pedagogëve efektiv ka ardhur në rritje. Kualifikimi i pedagogëve me grada dhe tituj shkencor tregon edhe nivelin e mësimdhënies që ata ofrojnë si dhe përgatitjen shkencore të tyre.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Nga verifikimi i Syllabuseve Programi i studimit është i ndërtuar nga lëndë të formimit të përgjithshëm, karakterizuese, të ngjashme dhe/ose integruese dhe lëndë me zgjedhje. Lëndët që trajtohen në vitin e parë janë lëndë të formimit të përgjithshëm, karakterizuese dhe të ngjashme dhe/ose integruese dhe një lëndë me zgjedhje. Lëndët e vitit të parë formojnë studentin dhe njëkohësisht e profilizojnë atë drejt financës dhe bankës. Në vitin e dytë lëndët që zhvillohen janë 3 lëndë të formimit karakterizues dhe një me zgjedhje, duke synuar profilizim të studentëve në

Financë dhe Bankë. Ngarkesa e lëndëve varion nga 175-200 orë në total. Në përgjithësi lëndët kërkojnë pjesëmarrje interaktive të studentëve gjatë orëve të mësimit dhe në përgjithësi lëndët kanë vlerësim për aktivizimin e studentit me 10% të totalit të vlerësimit, studentët zhvillojnë provim të ndërmjetëm ku vlerësohen maksimalisht me 20% të vlerësimit total. Studenti përgatit edhe një detyrë kursi për të cilën vlerësohet me 10% të pikëve totale dhe provimi përfundimtar zë 60% të vlerësimit total. Në syllabuse është e përcaktuar Literatura bazë dhe ajo ndihmëse.


Nga vlerësimi ynë konkluduar se në lëndën Strategjitë e Marketingut Bankar studentit zhvillon ose provim mes semestri, ose ese për të cilën vlerësohet me 10 te vlerësimit total. Nuk është e qartë nëse studentit zgjedh formën e vlerësimit apo pedagogu cdo fillim viti vendos vet. Edhe në lëndën Financat e Korporatave, studentit zhvillon provim të ndërmjetëm ose ese, e papërcaktuar kjo, për të cilin vlerësohet me 30% te vlerësimit total. Mendojmë se format e vlerësimit të studentëve duhet të jenë të qarta dhe të përcaktuara.

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Në pjesën e parë, të syllabusit jepet një përshkrim i përgjithshëm i lëndës. Detajohet ngarkesa në kredite si dhe përcaktimi nëse lënda është e detyrueshme apo lëndë me zgjedhje. Nëse do të bëjmë një renditje të elementeve bazë të syllabuse, do të vijin objektivat e lëndës. Objektivat e lëndës do të shpjegojnë mënyrën sesi studentët do të pajisen me njohuritë e duhura për atë çfarë lënda ka në përmbajtjen e saj. Më pas paraqiten format dhe metodat e mësimdhënies, duke filluar me leksionet në auditor, auditoret e hapura me të ftuar nga personalitete dhe ekspert te fushave të caktura dhe duke vazhduar me diskutime, debate gjatë seminareve të programuara. Ngarkesa mësimore është pjesë detyruese e komponenteve të syllabusit, në të cilën realizohet përputhja e orëve mësimore me ato të përcaktuara në planet mësimore. Detyrimet për studentin janë gjithashtu të përcaktuara në syllabus me qëllimin, që të bëhet e mundur informimi i studentëve mbi detyrimet që ata kanë kundrejt lëndës. Forma e vlerësimit të studentëve do të jetë e unifikuar për të gjitha lëndët, duke e ndarë vlerësimin në përqindje dhe konkretisht 60% të lëndës e përbën nota përfundimtare, dhe 40% vlerësimet e ndërmjetme. Një ndarje e tillë është menduar të realizohet me synimin që studentët të jenë prezentë gjatë gjithë orëve në auditor, si dhe orëve jashtë tij të mendojnë mbi realizimin e detyrave të ngarkuara nga pedagogu i lëndës. **Syllabuset janë të papërshtatura me shtojcën 2 të VKM 41 dt 24.01.2018, madje ato nuk kanë pësuar asnjë ndryshim as në formë as në përmbajtje që nga momenti i hapjes së PS për më tepër që në gjithë këto vite literatura ka pësuar ndryshime.**

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	




<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Financë - bankë, është hapur në bazë të Urdhërit nr. 482 datë 03.10.2011 të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës dhe Akredituar me Urdhërin nr. 291 datë 11.07.2012. Mbështetur në ligjin nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ky institucion ofron programe studimi bazuar në kërkesat e sistemit të Bolonjës sipas legjislacionit shqiptar. Programi i studimit Msc Financë-Bankë ka filluar në vitin 2011.</p> <p>Institucioni është i akredituar institucionalisht</p> <p>Në cdo vit akademik studenti ka mundësi të marrë 60 kredite. Ky program studimi ka 120 kredite në total ose nga 60 kredite në secilin vit akademik.</p>
---	--

Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.

<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master</p>	<p>Programi Master i Shkencave në Financë-bankë i orienton studentët për një edukim cilësor të qëndrueshëm me anë të mësimdhënies, kontributit në kërkim shkencor të thelluar, përdorimit të arritjeve më të mira dijes dhe të shkencës. Programi i studimit ka si qëllim formimin e ekspertëve dhe specialistëve të mirëfilltë në fushën e financave, bankave, sigurimeve dhe institucioneve të tjera financiare me anë të formimit teorik dhe praktik të studentëve në fushën e drejtimit të kontabilitetit, menaxhimit financiar, menaxhimit dhe teknikave bankare, auditimit, pasqyrave financiare, etj.</p> <p>Programi i studimit në vetëvete, ka si qëllim t’i pajisë studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale me qëllim që tu shërbejnë në tregun e punës por edhe në të ardhmen duke qenë të aftë të zgjerojnë njohuritë e marra si gjatë zhvillimit të programit edhe në vazhdimësi. Pas përfundimit me sukses të programit Master i Shkencave në Financë-bankë, studentët kanë krijuar baza të forta njohurish për të vazhduar më tej ciklin e tretë të studimeve atë të doktoratës. Në përfundim të këtij programi njohuritë përfshijnë aftësimin e studentëve për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve për të qenë të përgatitur për ciklin e programeve të doktoratës.</p>
--	---

<p>Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
<p>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodot e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Objektivat e programit të studimit Msc në Financë-bankë përputhen me strategjitë e institucionit. Sipas RVB programi i studimit Msc në Financë-bankë në veprimtarinë e tij paraqitet në përputhje me planin strategjik të zhvillimit institucional, kërkimit shkencor, bashkëpunimit dhe ndërkombëtarizmit 2012-2017. Programi i studimit Msc Financë-bankë ka si objektiv të zhvillojë dijet e mëtejshme të studentët që kanë formim të nivelit Bachelor. Programi i studimit Msc në Financë - bankë ka objektiv të pajisë studentët me njohuri teorike dhe praktike si dhe një vizion për studime të thelluara në fushën e financës. Në këtë program universiteti ka si objektiv ofrimin e kushteve optimale të zhvillimit të mësimin dhe angazhimin e një stafi të kualifikuar. Metodot e vlerësimit që janë përmendur në syllabus dhe</p>
	<p>nga takimet me stafin akademik dhe studentët, janë ndër metodat që përdoren sot gjerësisht në mësimdhënie, duke i përfshirë studentët në mënyrë aktive, të jenë të interesuar dhe dinamik në përfitim të dijeve dhe aftësive aplikative.</p>
<p>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikën e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Për hartimin e programit të studimit, UMSH është mbështetur në eksperiencën europiane por dhe në eksperiencën më të mirë shqiptare. Programi ka nisur në vitin 2011 dhe njihet 6 breza të diplomuarish, të cilët lehtësisht kanë gjetur vehten në tregun e punës. Diploma që përfitohet në fund të programit dhe suplementi i diplomës lejojnë studentin të transferohet në një IAL jashtë vendit për studime të mëtejshme.</p> <p>Programi është hartuar në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe orientohet nga integrimi evropian i vendit dhe zhvillimi ekonomik i tij.</p>
<p>Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p>	<p>Programi i studimit Msc në Financë-bankë, ka një përputhje të njohurive teorike me ato praktike. Studentët ndjekin një praktikë profesionale përpara diplomimit, duke i afuar më shumë me tregun e punës.</p> <p>Objektivat e programit të studimit Msc në Financë-bankë përputhen me strategjitë e institucionit. Sipas RVB programi i studimit Msc në Financë-bankë në veprimtarinë e tij paraqitet në përputhje me planin strategjik të zhvillimit institucional dhe kërkimit shkencor. Përfshirja e një stafi akademik të kualifikuar mgjse PAK,</p>

<p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>tregon për cilësi të mësimdhënies. Stafi PAK ka qëndrueshmëri duke qënë i përfshirë që në vitet e para të formimit.</p> <p>Stafi akademik efektiv është në proces kualifikimi dhe është i përfshirë maksimalisht në punë kërkimore shkencore.</p>
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>N/A</p>
<p>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p>	<p><i>Institucioni nuk ka paraqitur një studim tregu për këtë program studimi.</i></p> <p>Studimi i tregut do të përcaktonte më saktë numrin e studentëve të diplomuar për të cilët tregu ka mangësi.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p><i>Ne rekomandojmë që institucioni duhet të përgatisë një studim të mirëfilltë tregu në mënyrë që kuotat e përcaktuar të jenë në të njëjtin kah me zhvillimet e tregut.</i></p> <p>Në objektivat e programit të studimit, institucioni përmend se të diplomuarit në këtë PS mund të punësohen në:</p> <ul style="list-style-type: none"> Në administratë publike Në administratën e institucioneve private Në organizma dhe organizata ndërkombëtare rezidente në Shqipëri, në organizata të shoqërisë civile, etj. <p>Por për këto konkluzione nuk janë mbështetur në studim tregu.</p>
<p>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi Master i Shkencave në Financë-bankë është hapur në mbështetje të Urdhërit nr 482 datë 03.10.2011 të Ministrisë të Arsimit dhe të Shkencës në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe nuk bie ndesh me interesat kombëtare, duke pasur synim parësor ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>
<p>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve “Master i Shkencave” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezhën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p>Programi Master i Shkencave në Financë-bankë realizohet nga 120 kredite europiane ECTS, në të cilat 35 kredite europiane përfshihen në projektin kërkimor dhe tezhën e përgatitur në fund të programit. Kohëzgjatja e tij realizohet në 2 vite akademike.</p>

Duf

[Signature]

<p>Kriteri 2 Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<p>N/A</p>
<p>Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).</p>	<p>N/A</p>
<p>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p>Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Programi ofron një kurrikul lehtësisht të kuptueshme ku secili modul jepet nga syllabusi përkatës. UMSH, siguron në këtë program studimi të gjithë informacionin e nevojshëm mbi modulet dhe syllabuset duke i vendosur në faqen zyrtare online në internet të Institucionit. Studentët mund ta marrin informacionin dhe në sekretari. Institucioni ka vënë në dispozicion të grupit të Vlerësimit të Jashtëm të gjithë këtë informacion të nevojshëm.</p> <p>Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme, nga pedagogu i lëndës në auditor, të shkruara dhe elektronikisht. Studentët kanë mundësi që për çdo paqartësi apo problem të komunikojnë me pedagogun që kryen tutoriatin.</p>
<p>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</p>	
<p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> <p>Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>Në përfundim të studimeve në Msc Finacë Bankë studenti kryen praktikë profesionale dhe një tezë.</p> <p>Praktika mësimore ka 15 kredite ECTS ndërda Teza ka 20 kredite ECTS</p> <p><i>Institucioni duhet të përshtasë ndarjen e moduleve në veprimtari sipas VKM, nr.41 dt 24.1.2018</i></p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p>	
<ol style="list-style-type: none"> 1. UMSH ka në themel të punës kërkimore shkencore, respektim rigoroz të procedurave të kërkuara dhe urdhëruar nga Ligji për Arsimin e Lartë dhe MASR. 2. Kurrikulat janë të qarta dhe me ndryshime përkatëse sipas ligjit në të gjithë vitet e funksionimit të PS 3. Organizimi i programit të studimit është në përputhje me standardet europiane, sipas të cilave lëndët ndahen në sistemin europian të krediteve ECTS. 4. Numri i studentëve nga viti akademik 2011-2012 ka ardhur në rritje. Por institucioni nuk ka një studim të 	

Standardet plotësohen.plotësisht

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Mësimdhënia është një aspekt i rëndësishëm për një program studimi, sepse format e mësimdhënies përcaktojnë edhe nxënien dhe cilësinë e mësimdhënies. Format kryesore të mësimdhënies janë leksionet, seminarët dhe laboratorët në lëndët ku ato zhvillohen. Format e mësimdhënies që janë përdorur në realizimin e programit të studimit Master i Shkencave në “Financë - bankë” janë leksionet, seminarët, ushtrimet praktika profesionale dhe orët e konsultimit. Në lëndët e programit është aplikuar zhvillimi interaktiv i leksioneve duke trajtuar çështjet kryesore të leksionit dhe duke u përpjekur të tërheqim vëmendjen e studentëve me pyetje të ndryshme, në mënyrë që leksioni të jetë sa më tërheqës dhe i kuptueshëm për ta. Është ndjekur kjo formë mësimdhënie edhe me qëllim që ndjekja e leksionit të mos kthehet në një detyrim rutinë për studentin, por të jetë sa më efektiv në arritjen e qëllimit që synohet nëpërmjet dhënies së leksioneve, që studenti të ketë mundësi të kuptojë më mirë çdo çështje që pedagogët synojnë të shpjegojnë nëpërmjet leksioneve. Leksionet zhvillohen në bazë kursi. Seminarët me grupe deri në 35 studentë. Në standartin e mësipërm kemi paraqitur orët në auditor dhe orët që punojnë studentët në mënyrë të pavarur me detajimet përkatëse. Leksionet në shumë lëndë janë më shumë se seminarët në disa lëndë sa dyfishi i seminareve ku është pedagogu ai që shpjegon dhe analizon tematikat përkatëse, ndoshta mund të shihet si mundësi një balancim orësh leksione dhe seminarë për të mos lodhur studentët me shumë orë leksioni në të njëjtën lëndë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet

Llojet e Formave të mësimdhënies (ndarja e orëve në auditor) për programin e studimit Msc Financë-Bankë janë të detajuara si më poshtë:

- | | |
|------------------------------------|--------------------|
| ▪ Për leksionet | 555 orë në auditor |
| ▪ Për Seminarët | 360 orë në auditor |
| ▪ Për Praktikën Profesionale | 360 orë në auditor |
| ▪ Provimi përfundimtar (Diplomimi) | 60 orë në auditor |
| ▪ Orë jashtë auditorit | 1665 orë |

Format e kontrollit të njohurive

Forma kryesore e kontrollit të dijes është provimi. Sipas rregullores mënyra të tjera të kontrollit të dijes mund të përcaktohen nga njësia bazë dhe miratohen nga njësia kryesore në programin e cdo lënde apo moduli. Në të gjithë syllabuset përcaktohet si formë e kontrollit të njohurive provimi përfundimtar. Në syllabuse përcaktohen edhe pikë vlerësimi nga aktivizimi dhe frekuentimi në seminar si dhe për detyra apo projekte kursi si dhe për provim të ndërmjetëm. Nga syllabuset mund të themi se provimi i ndërmjetëm dhe provimi përfundimtar zënë rreth 70-80 % të vlerësimit të kontrollit të njohurive.

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Sipas RVB numri i studentëve të aktivizuar në projekte shkencore në rang fakulteti është 12 por jepen dhe një numër i studentëve të përfshirë në projekte të departamentit apo të vet pedagogëve. Institucioni nuk ka dorëzuar ndonjë dokument ku të tregohet përfshirja e këtyre studentëve në këto veprimtari. Megjithatë studentët e këtij programi ishin pjesëmarrës aktiv në Panairin e Ideve.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Procedurat e pranimit të studentëve bazohen në rregulloren e institucionit dhe bazë është cdo përcaktim ligjor i kriterëve të pranimit. Nga të dhënat e ofruara nga institucioni vihet re një rritje e qëndrueshme e numrit të studentëve të cilët ndjekin këtë program studimi. Numri i studentëve në këtë program është rritur ndjeshëm që nga viti i parë akademik i funksionimit të tij nga 14 studentë në 2011-2012, në 140 studentë në vitin aktual. Studentët që rregjistrohen për të ndjekur këtë Master kanë një mesatare në hyrje që varion nga mbi 6.66- 8.2. Në total në këtë Mastër janë rregjistruar 662 studentë, ku studentët e dy viteve të fundit ende nuk kanë përfunduar studimet. Nga vitet 2011 deri në 2016 janë rregjistruar 371 studentë dhe janë diplomuar 251, pra një përqindje diplomimi prej 67% e studentëve të rregjistruar.

Nuk ka informacion në lidhje me kalueshmërinë. Institucioni ndjek ecurinë e studentëve në tregun e punës në lidhje me punësimin e tyre dhe ka statistika të sakta në lidhje me punësimin në përputhje apo jo me diplomën. Studentët informohen me cdo aspekt të jetës akademike, me kriteret e

pranimeve, mundësitë e punësimit, etj. Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës nëpërmjet Zyrës së këshillimit të karrierës.

Procedurat e pranimit të studentëve

Pranimi i studentëve të rinj për të ndjekur studimet në Fakultetin e Shkencave Ekonomike në programin e studimit Master i Shkencave në Financë - bankë në ciklin dytë të studimeve bëhet bazuar në legjislacionin në fuqi të përcaktuar nga Ministria përgjegjëse për arsimin, në Statutin dhe Rregulloren e Organizimit të UMSH dhe në Rregulloren e Programit të Studimit. Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit bëhet publik në faqen zyrtare të UMSH, në broshurën informuese dhe gjatë fushatës së marketingut. Procesi i informimit të studentëve të ardhshëm koordinohet nga Sekretaria Mësimore dhe Pranimet në bashkëpunim me ZKSK. Kriteret e pranimit të studentëve për vitin në vijim 2018/2019 janë Diploma e ciklit të parë, certifikatë e njohjes së një prej 5 gjuhëve kryesore të BE. Departamenti në bashkëpunim me Dekanatin bën renditjen e aplikantëve duke u bazuar në këto kriteret: 60% të pikëve e zë nota mesatare, 20% të pikëve i zë përputhja me profilin e ciklit të parë, 20% të pikëve kualifikime dhe eksperiencia.

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Procedura e pranimit të studentëve jepet në rregulloren e Programit të studimit Msc Financë-bankë, neni 11-14. Sipas vendimit të Universitetit Mesdhetar Nr.2/1, datë 07.02. 2018 për përcaktimin e kriterit të pranimit të studentëve Universiteti Mesdhetar bazohet në Ligjin 80/15 "Per arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë".

Për ciklin e dytë të studimit kriteri bazë për pranimet për vitin 2018-2019, është nota minimale mesatare e përcaktuar nga vendimi i Këshillit të Ministrave për këtë vit akademik dhe zotërimi i diplomës së nivelit të parë të studimeve si dhe certifikimi i një prej gjuhëve të huaja të përcaktuara në Ligjin e Arsimit të Lartë.

Studentë të regjistruar në vitin e parë (për herë të parë) nota mesatare

Studentët e regjistruar në vitin e parë akademik 2011-2012 janë **14 studentë** ndërsa në vitin aktual janë **140 studentë** ku shikohet qartë rritja e numrit të studentëve. Nota mesatare në hyrje ka pësuar luhajtje nga viti në vit (Tabela 11 ne Aneks) me një minimum 6.66 dhe një maksimum 8.2. Institucioni pas vizitës ka dorëzuar të dhënat mbi mesataren në dalje të studentëve. Vihet re se studentët ruajnë të njëjtën mesatare si ajo në hyrje. Gjithsej të regjistruar në vite për herë të parë apo me transferim janë **662 studentë**.

Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

Tabela vijuese jep informacion në lidhje me të regjistruarit dhe të diplomuarit sipas viteve. Këto janë të dhënat e ofruara nga institucioni. Nuk ka informacion specifik në lidhje me Studentë të diplomuar në vitin e fundit pa vite përsëritëse.

Tabela: Të dhëna për regjistrimin studentëve

Sipas Viteve	Të regjistruar për herë të parë në vitin e parë (a)	Nota mesatare ne hyrje	Studentë të transferuar sipas viteve (b)		Studente te transferuar per Brezat (b)	Totali: (a)+(b)	Te Diplomuarit	Nota mesatare në dalje
			Viti I	Viti II				
2011-2012	14	7			0	14		
2012-2013	45	7.9			0	45	13	7.8
2013-2014	43	8.2	6	1	7	50	34	7.6
2014-2015	69	7.4	28	38	66	135	58	7.7
2015-2016	122	6.8		5	5	127	50	6.9
2016-2017	130	6.66	6	13	19	149	96	6.6
2017-2018	140	7		2	2	142	-	-

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Universiteti Mesdhetar ka një procedurë të qartë të transferimit të studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend. Procedura e transferimit bazohet në Udhizimet që nxjerr MASR në vitin akademik përkatës, në udhëzimet që nxjerr vet UMSH dhe në Statutin dhe rregulloren e UMSH. Sipas procedurës studentët bëjnë kërkesë pranë dekanatit dhe ky i fundit merr vendimin e transferimit bazuar në Udhëzimet dhe rregullat e përmendura më sipër. Nga të dhënat që disponojmë nga institucioni shihet që institucioni ka studentë të transferuar pranë tij nga universitet e tjera brenda vendit, e verifikuar edhe nga rregjistrat në vizitën në institucion. 99 studentë janë transferuar në këtë program që nga fillimi i funksionimit të tij.

Të dhëna për punësimin e studentëve

Numri total i të punësuarve në përputhje ose jo me diplomën është 232.

Numri total të diplomuarve

Gjithsej numri i të diplomuarve në këtë program studimi është 251 studentë nga viti 2013-2017. Numri i të diplomuarve është rritur nga viti në vit, kjo e lidhur në mënyrë të drejtëpërdrejtë me rritjen e numrit të studentëve të regjistruar.

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

Numri total i të punësuarve në përputhje me diplomën është 182.

Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

Numri total i të punësuarve jo në përputhje me diplomën është 50.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Të dhëna mbi të regjistruarit dhe të diplomuarit, përmbledhje e procedurës së transferimit, kriteret e pranimit të studentëve 2018-2019 UMSH, udhezim praktikat.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>Për pranimin në ciklin e dytë të studimeve “Master i Shkencave” kandidatët duhet të kenë përfunduar me diplomim studimet universitare të ciklit të parë në përputhje me aktet ligjore dhe Rregulloren e Programit të Studimit.</p> <p>Universitetit Mesdhetar i Shqipërisë merr vendim në lidhje me kriteret e pranimit të studentëve ku kriteri kryesor është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian.</p> <p>Përzgjedhja e kandidatëve për pranim në Fakultetin e Shkencave Ekonomike bëhet nga një komision i caktuar nga Dekani, mbështetur në dokumentacionin e paraqitur si dhe nga shqyrtimi i dosjes personale të kandidatit.</p> <p>Gjithashtu UMSH merr parasysh edhe mundësinë e vendosjes së kriterëve shtesë për pranimin e studentëve në bazë të statutit dhe rregullores.</p>
Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve; ion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të</p>	<p>Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve në momentin e fillimit të studimeve. Studentët informohen për të gjitha këto që në momentin e aplikimit për ndjekjen e studimeve pranë UMSH.</p> <p>Studentët informohen me çdo aspekt të jetës</p>

karrierës.

akademike, me kriteret e pranimeve, mundësitë e punësimit, etj..Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës nëpërmjet Zyrës së këshillimit të karrierës.

Nëpërmjet Zyrës së këshillimit të karrierës studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.

Në UMSH përvec zyrës së karrierës funksionon edhe sistemi tutorial, ku një pedagog ndjek ecurinë, problematikat dhe këshillon studentët për të cilët ai është tutori. Një pedagog është tutori i dy grupeve mësimore me studentë.

Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve. Gjatë vizitës në institucion ne u takuam edhe me studentë të Masterit Shkencor në Financë bankë. Ata ishin njoftuar për procedurën e akreditimit të programit të studimit. Gjatë takimit u vu re mendimi shumë pozitiv i tyre në lidhje me UMSH. Ata ndjeheshin pjesë e institucionit pasi ishin ata që nëpërmjet opinionit apo vlerësimit të pedagogëve ndihmonin në përmirësimin e mëtejshëm të PS. Në përfundim të cdo semestri studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde me anë të një pyetësoari që ju jepet për tu plotësuar nga departamenti përgjegjës.

Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.

Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;

Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;

Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.

Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, për numrin e të transferuarve drejt institucionit nga Institucione të tjera të arsimit të lartë brenda vendit.

Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.

Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve, në ciklin e dytë, për mesataren me të cilën janë pranuar.

Institucioni në dokumentacionin e dorëzuar ka paraqitur numrin e studentëve të regjistruar për herë të parë, numrin e studentëve të transferuar, mesataren në hyrje dhe mesataren në dalje të të diplomuarve.

	<p>Gjatë vizitës në institucion, u vunë re problematika në plotësimin e regjistrave. U vunë re studentë pa numër matriculimi. Në kolonën e vendosjes së datës së Diplomimit të Msc ishte vendosur data e diplomimit të Bsc, por edhe kjo jo në të gjithë studentët.</p> <p>Stafi administrativ në ngarkim të sekretarisë, nuk mund të jepte përgjigje për mënyrën e plotësimit të regjistrave.</p>
<p>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikën e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve nëpërmjet zyrës së këshillimit të karrierës.</p> <p>Tutorët e përcaktuar të studentëve ndjekin ecurinë e studentëve dhe të gjitha çështjet apo problematikën që kanë të bëjnë me procesin mësimor.</p> <p>Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre. Institucioni disponon të dhëna edhe nëse studentët janë punësuar apo jo në përputhje me diplomën.</p> <p>Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve. Nisur nga të dhënat e tyre na komunikuan se pjesa më e madhe e studentëve në nivelin e dytë janë studentë që kanë përfunduar po në UMSH nivelin e parë të studimeve.</p>
<p>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve në momentin e fillimit të studimeve. Studentët informohen për të gjitha këto që në momentin e aplikimit për ndjekjen e studimeve pranë UMSH.</p> <p>Në procesin e informimit dhe pranimit të studentëve jepet një informacion i detajuar për programin, për kohëzgjatjen, ngarkesën si numër lëndësh dhe pedagogët që i zhvillojnë. Departamenti ka kontakte të vazhdueshme me</p>

studentët, duke i orientuar ata mbi programet dhe kurrikulat e lëndëve si dhe mbi lëndën me zgjedhje, praktikat profesionale etj. Kjo na u bë e ditur nga Departamenti dhe gjatë bisedës me studentët.

Informacioni u përcillet studentëve nga departamenti si dhe pedagogu i lëndës. Cdo syllabus përmban informacionin e nevojshëm rreth mënyrës së vlerësimit, literaturën, frekuntimin dhe elementë të tjerë të nevojshëm për informimin e studentëve.

Studentët njihen me vlerësimet, ku gjatë vizitës na u komunikua se rezultatet përmbillen në një afat maksimalisht 5 ditor. Pas daljes së notës studentët kanë mundësi për ankimim në rast se ai e gjykon se duhet të bej ankimim dhe i jepet shpjegim për rezultatin.

Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.

Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;

Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.

Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës nëpërmjet Zyrës së këshillimit të karrierës.

Në UMSH përvec zyrës së karrierës funksionon edhe sistemi tutorial, ku një pedagog ndjek ecurinë, problematikën dhe këshillon studentët për të cilët ai është tutori.

Një pedagog është tutori i dy grupeve mësimore me studentët. Megjithatë studentët u shprehën se ata komunikonin edhe me përgjegjësen e njësisë bazë në rast problematike dhe gjithmonë gjenin zgjidhje të shpejtë.

Institucioni ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale.

Për kryerjen e praktikave institucioni ka lidhur një sërë marrëveshje bashkëpunimi me institucione apo biznese të ndryshme.

Cdo pedagog mbikëqyr 8-12 studentë në praktikë.

Studenti dorëzon dosjen e praktikës në bazë të rregullores së praktikës. Për Praktikën profesionale studentit vlerësohet me notë.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve në momentin e fillimit të studimeve.
2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, numrin e studentëve të regjistruar për herë të parë, numrin e studentëve të transferuar, mesataren në hyrje dhe mesataren në dalje të të diplomuarve, megjithatë u vu re se

institucioni kishte probleme në plotësimin e regjistrave.

3. Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre, nëse studentët janë punësuar apo jo në përputhje me diplomën.
4. Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës nëpërmjet Zyrës së këshillimit të karrierës. Në UMSH përveç zyrës së karrierës funksionon edhe sistemi tutorial, ku një pedagog ndjek ecurinë, problematikat dhe këshillon studentët.
5. Institucioni ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, institucioni ka lidhur një sërë marrëveshesh të cilat ndihmojnë edhe në këtë drejtim.
6. Kishte studentë pa numër matrikullimi, sidomos në studentët e transferuar.

Standardet plotësohen pjesërisht Kjo sepse: Institucioni duhet të punojë në përmirësimin e sekretarisë mësimore, në kualifikimin e stafit administrativ, pasi nga vizita në institucion u vunë re problematika serioze.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

11.

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka ngritur në përbërje të njërive kryesore edhe Qendrën e Kërkimit Shkencor e cila mbikëqyr kërkimin shkencor të stafit dhe studentëve. Gjithashtu është ngritur për këtë qëllim edhe zyra e projekteve. Politika e kërkimit shkencor në këtë program studimi duket shumë kërkuese. Kërkimi shkencor si një faktor shumë i rëndësishëm për institucionet e arsimit të lartë është institucionalizuar jo vetëm me hapjen e zyrës së kërkimit shkencor po edhe me pozicionin e një Zv. Rektori për zhvillimin dhe mbikëqyrjen e kërkimit shkencor. Politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi konsiston në rritjen e nivelit shkencor të pedagogëve, nëpërmjet botimeve në revista shkencore, pjesëmarrje në konferenca, nxitje të marrjes së gradës Phd në universitete të huaja. Cdo fundviti institucioni pasi bënë vlerësimin e performancës së stafit dhe nxjerr edhe detyrat e ardhshme në lidhje me kualifikimet dhe kërkimin shkencor të secilit. Institucioni mbështet financiarisht stafin për avancimin e karrierës së tyre dhe specifikisht në drejtim të kërkimit shkencor duke paguar tarifat e botimeve apo publikimit si dhe shpenzime të tjera mbështetëse. Institucioni mbështet edhe botime librash dhe monografish me kërkesë të pedagogëve. Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë boton revistën shkencore me Bord Editorial

EUROMEDITERRANEAN ku pedagogët kanë mundësi të ballafaqojnë mendimet e tyre shkencore. Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë organizon Konferencë Ndërkombëtare Shkencore vjetore. Në Konferencën Shkencore ftohen të marrin pjesë edhe studentët. Studentët marrin pjesë në mënyrë aktive në aktivitetin shkencor të studentëve Panairin e Ideve që organizon UMSH cdo vit. Po në funksion të ndjekjes së politikës së kërkimit shkencor institucioni ka lidhur shumë marrëveshje bashkëpunimi me organizma qeveritarë, institucione vendase dhe të huaja si dhe aplikon për të qenë pjesëmarrës në projekte të ndryshme.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për kërkimin shkencor

Në dokumentacionin e derguar nga Institucioni UMSH janë CV e pedagogëve, në përbërje të të civate duket një aktivitet shkencor i bollshëm dhe shkencor. Pedagogët kanë marrë pjesë në një numër të konsiderueshëm konferencash dhe kanë publikime në revista të ndryshme shkencore. Gjithashtu disa nga pedagogët janë edhe autorë librash universitar. Sipas të dhënave nga informacioni i dhënë nga UMSH dhe nga RVB janë 3 projekte të fituara, njëri ka përfunduar ndërsa dy janë në proces.

Sipas të dhënave nga informacioni i dhënë nga UMSH dhe nga RVB janë 3 projekte të fituara dhe të zbatuara. Dy nga projektet janë pjesë e programit Erasmus +, njëri është në vijim ndërsa tjetri ka përfunduar. Projekti i tretë që është në vijim është pjesë e EU Programme: European cooperation for Science and Technology. Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga UMSH janë 7, sipas RVB. Sic është përmendur më sipër Institucioni organizon Konferencë Ndërkombëtare Shkencore dhe Panairin e Ideve.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Personeli akademik efektiv, sidomos ata të cilët janë të përfshirë në proces doktorature, janë aktiv në punën kërkimore shkencore. Një fakt i tillë rezulton dhe nga statistikat, të cilat mbahen periodikisht, por dhe nga të dhënat e përgjithshme që disponon departamenti Financë Bankë Kontabilitet apo raportimet individuale të secilit pedagog. Institucioni ka një revistë shkencore jo periodike, dhe zhvillon konferenca shkencore dhe në bashkëpunim me Universitete të tjera në vend.</p>
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	

Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;

Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.

Institucioni nuk ofron programe në gjuhë të huaj. Kjo e bën të vështirë këmbimin në programet Erasmus+.

I rekomandojmë institucionit që të ofrojë leksione në gjuhë të huaj në mënyrë që të tërheq studentë të huaj në këtë program studimi.

Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.

Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;

Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.

Institucioni ka përkrahur në mënyrë të vazhdueshme personelin akademik që është në fazë kualifikimi.

Institucioni ka ndihmuar stafin për pjesëmarrje në konferencat apo botimet e vet Universitetit pa pagesë.

Institucioni gjithashtu garanton vijueshmërinë në punë të stafit i cili shkeputet për kualifikime të mëtejshme me iniciativë personale.

Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.

Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;

Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;

Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.

Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë" disponon të dhënat për studimet shkencore të personelit akademik të angazhuar në programin Master i Shkencave në Financë Bankë. Këto të dhëna janë të aksesueshme dhe lehtësisht të verifikueshme pasi në departament disponohen dosjet përkatëse mbi publikimet shkencore të stafit.

Universiteti disponon dhe të dhënat për përfshirjen e institucionit në projekte të ndryshme.

Institucioni ka vënë në dispozicion të gjithë dokumentacionin përkatës në këtë rast.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Institucioni ka prioritet kërkimin shkencor. Staf i akademik efektiv është i përfshirë në proces doktorature dhe kjo bën që kërkimi shkencor të jetë në qendër të diskutimeve në nivel departamenti.
2. Institucioni ka paraqitur një listë të projekteve ku Universiteti ka aplikuar dhe është përfshirë gjithë në pasqyrat financiare nuk përfshihet si zë të ardhurat nga projektet.
3. Institucioni disponon në dosjet e pedagogëve, informacion në lidhje me punën shkencore të çdo anëtari të departamentit.
4. Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë" ka krijuar struktura të posaçme për mbarëvajtjen dhe mbikqyrjen e vazhdueshme të rritjes së punës shkencore. Tregues konkret të sa më sipër janë organizimi i konferencave shkencore, botimet në revistat me faktor impakti si dhe vetë punimet e stafit akademik dhe i studentëve në nivelin Master.

Standardet plotësohen plotësisht.

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Pranë Institucionit është ngritur Zyra e projekteve. Zyrës së Kërkimit Shkencor dhe Zyra e projekteve merret me aplikime në projekte të mundshme, dhe ndjek zbatimin e tyre. Këto dy zyra në bashkëpunim, si dhe drejtuesit e institucionit kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me pushtetin lokal, dhomën e tregtisë, biznese të ndryshme, me universitete brenda dhe jashtë vendit. Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë është pjesë e programit ERASMUS. Në RVB theksohet se Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë vlerëson të rëndësishme vecanërisht marrëveshjet me universitete të huaja, me qëllim shkencor si pjesëmarrje në aktivitete shkencore dhe përafrim të kurrikulave. Institucioni në dokumentacion ka dhënë një kopje të marrëveshjeve me të gjitha specifikat e tyre. Në to përcaktohet qartë qëllimi, parimet e bashkëpunimit si dhe kushtet e bashkëpunimit sipas kërkesave të bashkëpunimeve. Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare, sipas RVB është 23. Institucioni ka organizuar në mënyrë të vazhdueshme leksione me lektorë vendas dhe të huaj si dhe tryeza të rrumbullakëta diskutimesh. Leksionet që janë zhvilluar kanë qenë pjesë e bashkëpunimeve kombëtare ose ndërkombëtare ose lektorët kanë qenë të ftuar nga Institucioni për të zhvilluar leksione në tematika të ndryshme. Leksionet me lektorë të huaj kanë qenë 218 orë mësimore. Numri i pjesëmarrësve në trajnime në fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit sipas RVB janë 8. Institucioni mbështet kërkimin shkencor jashtë vendit duke mundësuar dhe financuar aktivitetet akademike jashtë vendit. Institucioni ofron mbështetje për mobilitete të stafit akademik dhe për mobilitete të studentëve si dhe për studime në ciklin e tretë të studimeve jashtë. Sipas RVB 3 studentë të UMSH kanë përfituar nga projekte Erasmus+. Në ambjentet e UMSH ndodhet edhe biblioteka me libra të fushave të ndryshme në funksion të programeve që ofron institucioni. Biblioteka është abonuar në QUESTA online duke ofruar kështu mundësinë e titujve të shumtë nëpërmjet bibliotekës online. Institucioni ka salla konferencash të cilat përdoren për aktivitete shkencore. UMSH boton revistën shkencore EUROMEDITERRANEAN. Sipas RVB numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime është 120.

Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me shumë institucione qeveritare. Kështu, është lidhur marrëveshje me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë me synim

hulumtime të përbashkëta, etj. UMSH ka lidhur marrëveshje me INSTAT për angazhimin e studentëve në kryerjen e praktikave profesionale atje si dhe për veprimtari të kërkimit shkencor të përbashkët.

Gjithashtu janë lidhur marrëveshje me institucione të tjera si Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, disa bashki etj.

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë**

Institucioni ka lidhur marrëveshje edhe me Organizata Profesionale kryesisht të huaja dhe Universitete. Në bazë të këtyre marrëveshjeve institucioni synon shkëmbim stafi, dhe studentësh. Këto marrëveshje kanë si qëllim edhe shkëmbimi i literaturës, apo nxitja e sipërmarrjeve të përbashkëta.

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi edhe me Komunitetin e biznesit, tregun e punës. Qëllimi i këtyre marrëveshjeve është kualifikimi, kryerja e praktikave dhe punësimi i studentëve.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

Informacion mbi aktivitetet e lidhura me marrëveshjet e bashkëpunimit dhe raport mbi angazhimin e UMSH në projekte

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
<p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>UMSH ka një sërë bashkëpunimesh me institucione të tjera si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bashkëpunimi me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, • Bashkëpunimi me Universitetin e Tiranës, Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit, • Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, • Kontrolli i Lartë i Shtetit, • Dhoma e Tregëtisë dhe Industrisë së Tiranës, Instituti i Statistikave të Shqipërisë, • Drejtoria e Pëgjithshme e Tatimeve, • Banka e Shqipërisë, etj. <p>Për bashkëpunimin në nivel lokal:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bashkinë Tiranë, • Bashkinë Durrës, • Bashkinë Sarandë, etj.

	<p>Bashkëpunimi ndërkombëtar me institucionet homologe është një ndër aspektet e rëndësishme të punës së Institucionit.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Memorandumin e Mirëkuptimit me Akademinë Diplomatike të Londrës, • CEMAS Sapienza (IT), • Marrëveshjet e Bashkëpunimit me Universitetin e Tuzlës në Bosnjë-Heregovinë, • LUM Jean Monnet University • Casamassima (BA), Itali, • Universitetin e Qipros, • Universitetin e Strugës, etj.
<p>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p>	<p>Institucioni ka vendosur kriteret e vlerësimit të stafit ku përfshihen edhe pjesëmarrjet në aktivitete shkencore duke nxitur kështu bashkëpunimet ndërmjet stafit në drejtim të karrierës. Sipas RVB në UMSH secili pjesëtar i stafit ka detyra të përcaktuara dhe kjo garanton një fryme bashkëpunimi shumë të mirë.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Institucioni ka në fokus:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Organizimin e aktiviteteve informuese dhe sensibilizuese • Bashkëpunimin në projekte • Identifikimin e fushave të bashkëpunimit në planin kërkimor • Shkëmbimin e eksperiencave dhe kapaciteteve institucionale, • Shkëmbimin e materialeve, studimeve të ndryshme dhe të rezultateve të punës studimore shkencore (sikurse janë: konferencat, revistat apo edhe botime të tjera), që realizohet nga të dyja Palët.
<p>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime</p>	<p>Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj. Institucioni ka dorëzuar dokumentacionin e të gjitha marrëveshjeve të lidhura me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</p> <p>Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione qeveritare për mundësi zhvillimi</p>

profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;

Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.

praktikash studentore dhe hulumtime të përbashkëta. Institucioni ka lidhur marrëveshje me institucione të huaja, universitete. Në bazë të këtyre marrëveshjeve institucioni synon shkëmbim stafi dhe studentësh. Institucioni ka lidhur marrëveshje me biznese të ndryshme të cilët ofrojnë mundësi për zhvillimin e praktikave profesionale dhe për punësim.

Institucioni ka hartuar një raport analitik për të gjitha marrëveshjet me qëllimet dhe përfitimet prej tyre.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit.
2. Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.
3. Institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me pushtetin lokal, institucione qeveritare, biznese të ndryshme, me universitete brenda dhe jashtë vendit

Standardet plotësohen plotësisht.

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

- Për rekomandimin "Të saktësohet emërtimi i lëndës "Menaxhimi Strategjik i Institucioneve Financiare" meqënëse programi flet më shumë për "Menaxhimin strategjik" në përgjithësi se sa për manaxhimin strategjik të Institucioneve financiare, duke saktësuar edhe titullarin e lëndës, institucioni ka saktësuar titullarin e lëndës, i cili është i njëjti në të dy lëndët. Përsa i përket programit, ai vazhdon të jetë i njëjtë, madje edhe literatura bazë është e njëjtë, me përjashtim të një literature, e cila është bazë tek "Menaxhimi Strategjik i Institucioneve Financiare" ndërkohë që është literaturë ndihmëse tek lënda "Menaxhimi Strategjik". Emërti i lëndës nuk ka ndryshuar.

Ky rekomandim është **plotësuar pjesërisht**.

- Të gjithë rekomandimet e tjera janë **përbushur plotësisht**.

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

a. Pika të forta:

1. Marrëveshje bashkëpunimi me pushtetin lokal, institucione qeveritare, biznese të ndryshme, me universitete brenda dhe jashtë vendit.

2. Pedagogë me kontratë me tituj dhe grada shkencore që kanë treguar qëndrueshmëri që në vitin e parë të hapjes së programit.
3. Numri i studentëve është 10 fishuar që nga viti i parë akademik i hapjes së programit, që tregon për vlerësimin që studentët kanë për universitetin për stafin akademik dhe kushtet e mësimdhënies.
4. Organizimi me sukses i veprimtarive apo aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare, në bashkëpunim me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit.
5. Marrëdhënia dhe komunikimi i ngushtë pedagoge-student nëpërmjet sistemi tutorial.
6. Ambjente me infrastrukturë dhe teknologji bashkëkohore që ndihmon zhvillimin cilësor të mësimin.

b.Pika të dobëta:

1. Një pjesë e stafit efektiv është relativisht i ri, duke ju referuar kohës që kanë punuar pranë UMSH gjë që sjell mungesën e eksperiencës. Stafit nuk njihet në kohë të institucionit, gjë që u vu re gjatë takimit.
2. Ky program mbulohet nga pedagogë me kontratë në masën 51%.
3. Syllabuset nuk janë rishikuar që prej akreditimit të parë megjithëse literatura bazë dhe ndihmëse kanë avancuar.
4. Pasiviteti i stafit akademik në aplikimin për grante kërkimore dhe projekte të financuara nga burime të huaja.
5. Mungesa e interesit të studentëve për të aplikuar në programet e mobilitetit.
6. Përfshirja e stafit akademik dhe ndihmës në shumë detyra apo funksione njëkohësisht. Staf administrativ të pakualifikuar për kryerjen e detyrave specifike si psh sekretaria mësimore.
7. Bibliotekë relativisht e varfër në literaturë shqip por edhe në gjuhë të huaj. Studentët e këtij PS duhet të kenë më shumë literaturë në gjuhë të huaj.

c. Mundësitë:

1. Rritja e kapaciteteve dhe eksperiencia e fituar, është një mundësi për rritje dhe zhvillim në mënyrë progresive si të numrit të studentëve ashtu dhe të burimeve njerëzore dhe logjistike.
2. Të rrisë mobilitetet e stafit dhe studentëve në sajë të marrëveshjeve
3. Të rishikohen kurrikulat që ofrohen me synim afrimin me lëndët më të fundit të fushës së ekonomisë.
4. Universiteti mund të shfrytëzojë numrin e lartë të bashkëpunimeve për pjesëmarrje në projekte.
5. Mundësitë e zhvillimit profesional dhe akademik të stafit, brenda dhe jashtë vendit, janë faktorë që ndikojnë në cilësinë e mësimdhënies dhe në zhvillimin e kërkimit shkencor.

d.Pengesat:

1. Staf relativisht i ri për të ofruar eksperiencia në kurrikula apo syllabuse.
2. Pjesëmarrje e ulët në projekte që lejon pak mobilitete stafi apo studentësh.
3. Financimi nuk duhet mbështetur vetëm në tarifat e studentëve. Departamenti duhet të përfshihet në projekte kërkimi, në mënyrë që të ketë një cilësi më të mirë të stafit akademik.
4. Ekzistenca e një numri në rritje Universitetesh Publike dhe Private në vend që ofrojnë të njëjtat /të ngjashme programe studimi, mund të cojë në problem lidhur me numrin e studentëve. Nga ana tjetër sjell dhe probleme në punësimin e këtij kontigjenti të diplomuarish.

(SWOT ANALYSIS)

a. strengths

1. The institution has cooperation agreements with local government, government institutions, and different businesses, with universities in and out the country.
2. The guest lecturers (with contract) with scientific degrees and titles that have shown sustainability since the first year of the program's opening.
3. The number of students since the first academic year of opening the program is multiplied by 10 times, which indicates the student's assessment of the university, the academic staff, and the learning conditions.
4. Successful organization of national and international activities in cooperation with other domestic and foreign institutions.
5. Close relationship and communication professor-student through the tutorial system.
6. Modern infrastructure and technology that helps in quality teaching.

b. weaknesses

1. Some of the effective staff is relatively new, referring to the time worked at UMSH, which results in a lack of experience. The staff does not know the institution's timely performance, which was noted during the meeting.
2. The teaching hours in this SP are 51% of the contracted pedagogues.
3. Syllabuses have not been revised since the first accreditation although the literature used has advanced.
4. Passivity of academic staff in application for research grants and projects funded by foreign sources.
5. Lack of student interest to apply to mobility plans.
6. Involvement of academic staff and support staff in many tasks or functions at the same time. Unqualified administrative staff to perform specific tasks such as the secretary.
7. A relatively poor library in Albanian literature but also in foreign language. Students of this SP need to have more foreign language literature.

c. opportunities

1. Increased capacity and experience gained is an opportunity to progressively increase and develop both the number of students and human and logistic resources.
2. Increase the mobility of staff and students thanks to agreements
3. Review the curricula that are offered, with the aim of approaching the latest subjects in the field of economics.
4. The University can use the high number of collaborations to participate in the projects.
5. The professional and academic development opportunities of staff, both at home and abroad, are factors that affect the quality of teaching and the development of scientific research.

d. threats

1. Relatively young staff to offer curriculum or syllabus experience.
2. Low active participation in projects that allows little mobility of staff or students.
3. Funding should not depend only on student fees. The department should be involved in research projects, in order to have a better quality of academic staff.
4. The reality of an increasing number of Public and Private Universities in the country that offer the same / similar study programs can lead to problems with the number of students. On the other hand, it also brings problems in hiring the graduates of this SP.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

Prof. Asoc. Dr. Doriana MATRAKU
Prof. Asoc. Dr. Etleva BAJRAMI

ANEKSE

Tabela 1: Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK)

Fakulteti i Shkencave Ekonomike 2017-2018	Numri i PAE		Numri i PAK		Në Total	
	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada
Departamenti i Financë Bankë dhe Kontabilitet	12	5	9	7	21	12
Departamenti i Ekonomisë	13	4	5	5	18	9
Departamenti i Informatikës dhe i Formimit Shkencor	14	5	6	6	20	11

Tabela 2: Lista e Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK) në Departamentet perkatese.

Fakulteti i Shkencave Ekonomike 2017-2018							
Departamenti i Financë Bankë dhe Kontabilitet							
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)	Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)	Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time		
1 Altin Hoti	Profesor	Prof Assoc.	1 Anastas Angjeli	Akademik	Kuvendi i Shqipërisë		
2 Andi Teqja	Asistent Lektor	Msc	2 Drini Salko	Prof	Univeristet i Bujqësor i Tiranës		
3 Aristotel Pano	Profesor	Prof	3 Eleana Lici	Dr	Universiteti Eqrem Çabej		
4 Armelina Lila	Asistent Lektor	Msc	4 Fatos Ibrahim	Prof.Assoc	Banka e Shqipërisë		
5 Elia Botka	Asistent Lektor	Msc	5 Ingrid Shuli Bucka	Prof	Universiteti i Tiranës		
6 Elona Shehu	Asistent Lektor	Msc	6 Kristal Hykaj	Dr	Ministria e Financave dhe Ekonomisë		
7 Festim Kodra	Asistent Lektor	Msc	7 Orfea Dhuci	Prof.Assoc	Alpha Bank		
8 Greta Angjeli	Profesor	Prof Assoc.	8 Rigersa Konomi	Msc	Drejtoria Rajonale Tatimore		
9 Rudina Qurku	Lektor	Dr	9 Silvana Lamaj	Msc	Bashkia e Tiranës		
10 Sonila Nikolla	Asistent	Msc					

		Lektor					
11	Violeta Haxhillazi	Asistent Lektor	Msc				
12	Vladimir Mici	Lektor	Dr				

Fakulteti i Shkencave Ekonomik Departamenti i Ekonomisë

Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time
1	Ira Gjika (Zogu)	Lektor	Dr	1	Hysen Cela	Prof	IEKA, Tiranë
2	Nikollaq Pano	Lektor	Dr	2	Liljana Elmai	Prof	UT, Fakulteti i Ekonomisë
